

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7819 E mërkurë 13 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

**A**nëtarëve të pesë familjeve që u përleshën me policinë tek gjimnazi "Petro Nini" nuk iu kishte mbetur asnjë mjet tjetër përpos dhunës. Ata i patën ...  
Vijon në faqen 20

Nga ANDI BUSHATI



Një fitore e vogël e "njerëzve të dhunshëm"

Opinion i Ditës

**N**jë nga anëtarët (shumë të rrallë, për fat të keq) kurajozë të Kuvendit të Shqipërisë, deputetit që pranoi të vozisë i vetëm kundër gjithë rrymës së partisë ...  
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI



Të trembëdhjetët në bronz



PS krijon aleancë parazgjedhore me 25 parti

## Basha: Rama i ka ditët e numëruara. Kryemadhi: Na u lut 6 muaj për koalicion

Borchardt i OSBE: Të hetohen akuzat për krim elektoral, opozita të hyjë në zgjedhje

Nga VALENTINA MADANI

Për liderin e opozitës, Lulzim Basha, Shqipëria e vlerave europiane nuk mund të jetë ajo me politikanë të lidhur me krimin. Ndaj Basha u shpreh dje se PD-ja është në këtë betejë për ndryshim dhe jo për pushtet. Kreu i opozitës ishte dje ...  
Në faqen 2-4

## KREU I ALUIZNI: 10 MIJE APARTAMENTE NE TIRANE KANE PERFITUAR LEJEN

# LAME: SHTEPITE PA HIPOTEKE, PROCEDURA PER LEGALIZIMIN

Kategoritë që përfitojnë nga ndryshimet në ligj. Artan Lame: Pallatet me probleme pronësie, banorët duhet të zgjedhin përfaqësues dhe të drejtohen tek ALUIZNI



(Në foto) Kreu i ALUIZNI-I, Artan Lame

Në faqen 7

TARIFA ABUZIVE

**Landfilli në Sharrë "vjel" paratë publike e private, shifrat**

Në faqen 9

REAGIMET

**Mjekët, protestë kombëtare kundër dhunës në detyrë: Qeveria, fajto**

Në faqen 10

LIGA E KAMPIONEVE

**Ronaldo i Joves një "përbindësh" në fushë, 3 gola fundosin Atletikon**

Në faqen 22

"SHOWBIZZ"

**Kur "dyshji" është numër fati, VIP-at shqiptarë që zgjedhën të bashkëjetojnë**

Suplement

INTERVISTA NE "NEWS 24"



**Anila Denaj: Kufizim koncesioneve PPP. Dhuna politike sjell trembjen e turistëve**

Në faqen 6

EMRAT/ Dosjet e viteve '93-2013, kujt i njihet e drejta e kompensimit

## Kompensimi, 6 mijë pronarët që marrin paratë

Agjencia e Trajtimit të Pronës: Familjet që ndajnë fondin financiar

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën e 6 611 pronarëve që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të



gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilën dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosje, të cilave Agjencia e Trajtimit të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohë në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të ...  
Në faqen 11-12

# KRIZA POLITIKE AKUZAT

Kreu i PD: Kur qeveria kapet duke vjedhur në Belgjikë, nuk ikin belgët azilantë

## Basha: Rama, sistem me 5 oligarkë që japin rryshfete të majme

"S"ka falje për grabitësit e pronave të shqiptarëve"

Valentina Madani

Për liderin e opozitës Lulzim Basha, Shqipëria e vlerave europiane nuk mund të jetë ajo me politikanë të lidhur me krimin. Ndaj Basha u shpreh dje se PD-ja është në këtë betejë për ndryshim dhe jo për pushtet. Kreu i opozitës, ishte dje në Berat dhe Urën Vajguore ku zhvilloi takime me banorët dhe me biznesin e vogël. Gjatë takimeve, z.Basha akuzoi se Rama ka ndërthurr një sistem ku ka ndërthurr interesat e 5 oligarkëve me rryshfete të majme për veten e tij dhe ministrat e tij. "Rama ka ndërthurr një sistem ku ka ndërthurr interesat e 5 oligarkëve me rryshfete të majme për vetëm e tij dhe ministrat e tij, se kur i rrotullon prapë se prapë punët aty me njëri-tjetrin illokoçisin. Ikën Damiani, vjen Belinda, Belinda bashkë me Damianin, bashkë me Afrimin. Nuk ka më qeveri. Kemi një bandë e cila është kapur duke vjedhur. Janë kapur duke vjedhur votat dhe në këtë moment ka prerë lidhjen me popullin. Në momentin që ai e merr pushtetin jo përmes votës ai nuk e ka më frikë qytetarin. Kemi një kryeministër që e ka mendjen të bëjë barsoleta, të tallet, dhe të bëjë paratë e shqiptarëve rrysh e kumbulla. Sa herë ta shikoni në ekran duke këputur mukfa ose duke bërë truket e veta gjoja me veshje, sa herë që është duke bërë atë, është duke vjedhur diçka të madhe. E ka mendjen që ju ta shikoni se si flet, çfarë vesh, në atë moment ai po bën një vjedhje të madhe. Në atë moment ai i ka dhënë një oligarku një kontratë, ose i ka falur një copë bregdeti, ose një pus naftë, një leje minerare, leje ndërtimi në kundërshtim me ligj duke pastruar paratë e drogës, ose ka devijuar lumin që të grabisë pronat e qytetarëve. Çdo moment propagandë e Edi Ramës, prapa kësaj fshihet një vjedhje e madhe", u shpreh Basha. Ai i ftoi të gjithë qytetarët të bëhen pjesë e protestës në 16 mars sepse ka ardhur koha e ndry-




Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje gjatë takimit të fasonëve në Korçë

### DEKLARATA

"Kjo qeveri është qeveri peng e krimin. Me bashkimin tuaj më 16 mars, ju investoni që qeveria e ardhshme të jetë peng e qytetarëve shqiptarë. Në Evropë kur kapet qeveria në Belgjikë duke vjedhur nuk ikin belgët azilantë, por bie qeveria dhe ministrat shkojnë në burg. Nuk do të ketë falje për ata që kanë grabitur paratë tuaja", tha z.Basha.

## Kryemadhi: Rama na u lut 6 muaj, por nuk pranuan të vinim në pushtet

Kryetarja e LSI, Moni dje banorët e Cërrikut nga ku hodhi akuzat të ashpra ndaj Kryeministrit Edi Rama. Por Kryemadhi foli edhe për lënien e mandatëve, duke përmendur se në të shkuarën kryeministri Rama i ka ofruar koalicion. Sipas Kryemadhit, të gjitha vizitat dhe mitingjet e Ramës financohen nga taksat që paguan populli. "Vendimi ynë ishte një vendim për të shkatërruar këtë lloj kalbje dhe për të ndërthurr një sistem të ri. Një sistem të ri me plot vlera që kemi ne si popull. Ne jemi një popull i varfër me bukuri që nuk i gëzojmë ne, po i gëzojnë 5 individë të caktuar që janë miq e shokë të Edi Ramës. Vendimi ynë nuk ishte për të marr push-



tetin në tavolinë. Për 6 muaj na u lut Edi Rama për të ardhur në pushtet, po nuk pranuan se po u bërë me qelbësirën, erë do vish. Shikojmë ato mitingjet e Edi Ramës sa më të bukura t'i bëj aq më keq janë, sa më të bukura të jenë ato mitingjet e tij, intervistat e tij në televizion janë të shumtë lekë nga taksat na merren ne", tha Kryemadhi. Kryetarja e

herë ama duhet të vendosi populli. Në qoftë se jeni dakord, kam një kërkesë për ju, bashkohuni në protestë në 16 mars, bashkohuni për hallet tuaja. 16 marsi është luftë për ndryshim, jo luftë për pushtet", deklaroi z.Basha. Më pas gjatë takimeve në Berat, kreu i PD-së, përmendi se në vendet evropiane kur qeveria kapet

### VENDIMI

"Vendimi ynë nuk ishte për të marrë pushtetin në tavolinë. Për 6 muaj na u lut Edi Rama për të ardhur në pushtet, por nuk pranuan se po u bërë me qelbësirën, erë do vish", u shpreh Kryemadhi.

LSI-së shtoi më tej: "Dëgjojmë të thuhet se duam reformë zgjedhore, reformë zgjedhore është në dosjet 339 dhe 184 që mbajnë peng të ardhmen e fëmijëve tanë dhe integrimin europian. Jemi të qartë në vendimin tonë se dalja e këtyre njerëzve përballë drejtësisë do të çlirohet dhe nuk do të lejonte asnjë të përfitonte nga shqiptarët".

duke vjedhur, nuk ikin populli por ministrat shkojnë para drejtësisë. "Të bashkohet me ne në 16 mars kush do uljen e taksave, uljen e cmimit të energjisë, një ekonomi me taksat të ulëta dhe vende pune. Orët e kësaj bande hajdute janë të numëruara. Parlament i krimin ka marrë fund. Nuk do të ketë falje për ata që



Protesta e opozitës para parlamentit

## PD nxjerr dokumentin: Filo miratoi vendin e depozitimit të mbetjeve nga TEC-i

Dega e PD, dega e Korçës publikoi dje dokumentin me firmën e Kryetarit të Bashkisë Korçë Sotiraq Filo, i cili, miratoi vendin e depozitimit të mbetjeve nga TEC-i. Në dokumentin e datës 11 shtator 2018, thuhet qartë se, venddepozitimi i mbetjeve inerte është përcaktuar të jetë fusha e vjetër e mbetjeve ndërsa mbetjet e tjera do t'i dorëzohen kompanisë kontraktore të bashkisë. Në një deklaratë për shtyp anëtarja e Kryesisë së PD Korçë, Ledina Alolli tha se ky dokument i siguar me firmë abuzimi dhe vullosur me vull turpi, është fytyra e vërtetë e Sotiraq Filos, i cili jo vetëm e ka mbështetur projektin "de facto", por edhe "de jure" me vendimmarrjen e tij, duke i hapur rrugë ndërtimit të TEC-it, pa pyetur dhe dëgjuar askënd, veç urdhërdhënësve të tij. "Pas firmës së Niko Peleshit, që i mundësoi kompanisë investitore, statusin e investitorit strategjik, kryetari i bashkisë Sotiraq Filo, ushtari i zellshëm që nuk di të thotë jo, firmosi lejen për venddepozitimin e mbetjeve, që do të gjeneroheshin nga vënia në funksion e TEC-it. PD e Korçës ka siguruar dhe po bën publik dokumentin e datës 11 shtator 2018, ku thuhet qartë se, venddepozitimi i mbetjeve inerte është përcaktuar të jetë fusha e vjetër e mbetjeve ndërsa mbetjet e tjera do t'i dorëzohen kompanisë kontraktore të bashkisë. Ky dokument i siguar me firmë abuzimi dhe vullosur me vull turpi, është fytyra e vërtetë e Sotiraq Filos, i cili jo vetëm e ka mbështetur projektin "de facto", por edhe "de jure" me vendimmarrjen e tij, duke i hapur rrugë ndërtimit të TEC-it, pa pyetur dhe dëgjuar askënd, veç urdhërdhënësve të tij" thuhet në deklaratën e PD-së së Korçës. Sipas PD-së, Sotiraq Filo firmos natën lejen për TEC-in dhe qan ditën para kamerave, që të zhbëjë atë për të cilin u investua bashkë me Peleshin.



kanë grabitur paratë tuaja. Jemi në këtë betejë për ndryshim dhe jo për pushtet. Të kemi bashkë një pakt kombëtar që të garantojë zhvillim dhe që sovran të jenë qytetarët dhe jo krimi. Në Evropë kur kapet qeveria në Belgjikë duke vjedhur nuk ikin belgët azilantë, por bie qeveria dhe minis-

trat shkojnë në burg. Nuk do të ketë falje për ata që kanë grabitur paratë tuaja. Një ditë e re po agon për vendin tonë. Jemi në këtë betejë për ndryshim dhe jo për pushtet. Të kemi bashkë një pakt kombëtar që të garantojë zhvillim dhe që sovran të jenë qytetarët dhe jo krimi" tha Basha.



Largohen nga koalicioni LSI, PDIU, FRD, PDK dhe partia e Ngjelës, mbeten komunistët

# PS krijon koalicion zgjedhor me 25 parti, i ikin aleatët e mëdhenj

"PD dhe LSI po tentojnë të na kthejnë në vitet '97 e '98"

**R**rudhet koalicioni i socialistëve. Partia Socialiste ka zhvilluar dje takimin e parë konsultativ me të gjitha partitë që kanë pranuar që të jenë në një koalicion zgjedhor me të. Takimin e ka drejtuar Sekretari i Përgjithshëm i PS-së, Taulant Balla dhe në të merrnin pjesë kryetarët dhe përfaqësuesit e të gjitha partive të vogla jo parlamentare që angazhohen që në zgjedhjet e ardhshme vendore të jenë në një koalicion me socialistët. Behet fjalë për një koalicion shumë më të vogël se ai i zgjedhjeve të 2015 dhe ku bien në sy mungesa e të gjitha partive politike që kanë vota. Kështu nga 37 forca që kishte koalicioni parazgjedhor i vitit 2015 kësaj here socialistët kanë mundur të krijojnë një koalicion me vetëm 26 parti, shumica e tyre anonime dhe pa vota.

### DEKLARATA

**DEKLARATA**  
Braktisja nga një grup deputetësh të PD dhe LSI të Kuvendit, të tempullit të demokracisë institucionale, synon të dëmtojë rëndë interesat tona kombëtare dhe strategjike në favor të interesave të ngushta të karrierës personale dhe llogarive partiake. Retorika dhe përdorimi i dhunës prej PD dhe LSI për qëllime politike tenton destabilizimin e vendit dhe kaosin shoqëror, duke na kthyer shumë vjet mbrapa, në të kaluarën me ngjarje të rënda të viteve '97 e '98".



## PS mbledh "shtabin" e Tiranës, Gjylameti: Nuk bëjmë kompromis për datën

Ndonëse opozita gjendet në rrugë duke protestuar kundër qeverisë, socialistët kanë nisur seriozisht përgatitjet e tyre për zgjedhjet e ardhshme vendore që sipas tyre do mbahen në datën e dekretuar nga Presidenti i Republikës, më 30 qershor. Në këtë kuadër është mbledhur dje në selinë e Partisë Socialiste shtabi organizativ i zgjedhjeve të Tiranës, ku veç kryetares së PS-së së kryeqytetit Blerina Gjylameti merrnin pjesë kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, sekretari Organizativ i PS, Arben Pëlumbi si dhe gjithë deputetët socialistë të Tiranës. Lajmin e bën të ditur vetë Gjylameti, e cila ka postuar edhe disa foto nga ky takim. "Bashkë me Erionin, Arbenin, deputetët e Tiranës dhe strukturën drejtuese të Partisë Socialiste Tiranë diskutuam mbi mbarëvajtjen e punës organizative për zgjedhjet lokale 2019. Kontrata jonë me qytetarët është e distancuar nga çdo kompromis, që del në kundërshtim me zgjedhjen dhe votën e tyre. Kushtetuta përcakton 30 qershorin si sfidën tonë të radhës dhe ne do të jemi aty me vëmendjen tek njerëzit për të përmirësuar çdo ditë e më shumë projektin e madh për Shqipërinë që duam", - shkruan Gjylameti.

Pas mbledhjes së zhvilluar në ambientet e një prej hoteleve kryesore në kryeqytet, partitë pjesëtare të kësaj tryeze dolën edhe me një deklaratë të përbashkët ku në qendër të saj ishte pikërisht situata politike në vend. Në këtë deklaratë të përbashkët partitë pjesëmarrëse në këtë tryezë theksojnë se braktisja nga një grup deputetësh të PD dhe LSI të Kuvendit, të tempullit të demokracisë institucionale, synon të dëmtojë rëndë interesat tona kombëtare dhe strategjike në favor të interesave të ngushta të karrierës personale dhe llogarive partiake. Gjithashtu, ato theksojnë se "Retorika dhe përdorimi i dhunës prej PD dhe LSI për qëllime politike tenton destabilizimin e vendit dhe kaosin shoqëror, duke na kthyer shumë vjet mbrapa, në të kaluarën me ngjarje të rënda të viteve '97 e '98". Nga ana tjetër partitë nënshkruese të kësaj deklarate bëjnë të ditur se mbështesin ndryshimet e propozuara të Kodit Zgjedhor dhe thellimin e këtyre ndryshimeve për të garantuar depolitizim të plotë të të gjithë administratës zgjedhore, pjesëmarrjen e emigrantëve në proceset zgjedhore dhe përdorimin e teknologjisë për numërimin elektronik të votave në një projekt pilot qysh në zgjedhjet vendore të 30 qershorit. Në fund ato deklarojnë se angazhohen për të ndërtuar një platformë të përbashkët për një koalicion funksional dhe fitues të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

### PARTITË E KOALICIONIT TË RI TË PS-SË

- Partia Socialiste
- Partia Social Demokratike
- Partia Demokratcia Sociale
- Aleanca Popullore
- Partia Socialiste e Moderuar
- Aleanca Demokratike
- Partia e Gjelbër
- Partia e Unitetit Kombëtar
- Partia G99
- Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet
- Partia Ardhmëria Shqiptare
- Partia Për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve
- Partia Socialpunëtore e Shqipërisë
- Partia e Reformave Demokratike Shqiptare
- Partia e të Drejtave të Mohuara
- Aleanca për Barazi e Drejtësi Europiane
- Partia e Punës së Shqipërisë
- Partia Komuniste e Shqipërisë - 8 Nëntori
- Partia Demokratike për Integrim dhe Prosperitet
- Partia Kristiandemokrate
- Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare
- Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen
- Partia e Gështjeve Shqiptare
- Partia Demokratcia e Re Europiane
- Partia Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve
- Partia Fronti i Majtë

### PARTITË QË JANË LARGUAR NGA KOALICIONI

- Lëvizja Socialiste për Integrim
- Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet
- Aleanca Arbnore Kombëtare
- Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian
- Partia e Bashkimit Mysliman të Shqipërisë
- Partia Aleanca Demokratiane e Shqipërisë
- Partia Forca Rinia
- Partia Komuniste e Shqipërisë
- Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim
- Partia Ligi dhe Drejtësi
- Partia për Europianizimin dhe Integrimin e Shqipërisë
- Partia Personat me Afësi të Kufizuar
- Partia Rrugë e Lirisë
- Partia Shqiptare Atdheu
- Fryma e Re Demokratike
- Partia Demokratiane e Shqipërisë

### KOALICIONI

Në fund të deklaratës janë renditur edhe emrat e 26 partive, përfshi këtu edhe Partinë Socialiste. Ndonëse nuk bëhet fjalë për një koalicion përfundimtar, burime nga PS bëjnë të ditur se ato janë parti që kanë shprehur angazhimin për të qenë në një koalicion. Por sipas të njëjtave burime mësohet se ky koalicion edhe mund të zgjerohet me parti të tjera. Gjithsesi duke gjykuar nga përberja aktuale, vihet re një koalicion shumë më i vogël se ai i zgjedhjeve të shkuara lokale. Ndërsa në 2015 PS arriti të krijojë koalicion me 36 parti të tjera, sot ajo ka mundur të gjej mbështetjen e vetëm 25 partive. Por jo vetëm kaq, pasi ajo që është edhe më negative për PS-në në këtë rast është se i kanë ikur nga koalicioni të gjitha partitë që kishin një numër të konsiderueshëm votash, përfshi këtu LSI, PDIU-në, FRD-në, PDK-në e disa parti të tjera që kanë një farë mbështetje në elektorat. Në total nga koalicioni i PS-së i 2015 kanë ikur plotësisht 16 parti, ndërsa ka mundur të afrojë ndonjë parti tjetër të vogël, siç është rasti i MEGA-s. Po ashtu socialistëve u kanë ikur si aleatë edhe Partia Rrugë e Lirisë e Kurt Kolës, si dhe një nga partitë komuniste. Por gjithsesi komunistët do vijnë të jenë sërish në koalicion me Partinë e Komuniste 8 Nëntori dhe Partinë e Punës.

## Përplasja te "Petro Nini", Rama: Policia ishte si trup pa kokë

Kryeministri Edi Rama ka reaguar dje sërish për përplasjen disa orëshe mes banorëve dhe policisë në afërsi të shkollës "Petro Nini Luarasi". Nëpërmjet rubrikës "Përgjigja ime" ai ka theksuar se qeveria nuk ka asnjë të drejtë të bëjë gjykatës dhe të gjykojë mbi vendimet e gjykatave. Rama ka sgaruar se pronarët e tokës kanë fituar të drejtën në gjykatë për të fituar pronësinë dhe se banorët që jetojnë në atë godimë kanë humbur në gjykatë. "Unë do të them çfarë di unë, pasi jam informuar në detaje, që edhe për mua dje ishte irrituese. Jam kontaktuar nga banorët kohë më parë dhe e kam marrë informacionin se janë në konflikt me palën tjetër që ka fituar me gjyq. Të zotët aktuale e kanë



humbur me vendim gjykatës formës së prerë, ndërsa trashëgimtarët kanë fituar. A është i drejtë vendimi i gjykatës? Na pëlqejnë, nuk na pëlqejnë, në sistemin që kemi zgjedhur nuk ka qeveri që i zhbën. Qeveria mund ta reformojë sistemin dhe ta

çlirojë nga korrupsioni dhe ta bëjë të denjë" - tha Rama. Më tej kryeministri u ndal te roli i policisë dhe shkarkimi i drejtorit të Policisë së Tiranës, që e cilësoi të drejtë dhe mësim. "Me ligj vendimet ekzekutohen nga përmbartimi, kur kërkon mbështetjen e policisë, policia është e detyruar që ta mbështetë. Duke shkuar në mbështetje të përmbartimit, policia zbatoi ligjin, por edhe pse prania ishte kërkesë e ligjit, sjellja e saj nuk ishte dinjitoze, trupa ishte nisur pa përgatitje, ku u krijuan vetëm skena të panevojshme, me njerëzit që shtriheshin në rrugë dhe policia nuk dinte se çfarë bënte, rrinin e lëviznin si një trup pa kokë, që krijojnë veç acarim", - u shpreh Rama.

# SHITBLERJA ZGJEDHJET

Kreu i Prezencës: Parlamenti legjitim, mund të votojë reformën zgjedhore

## OSBE, Borchardt: Të hetohen akuzat për krim elektoral

"Opozita të marrë pjesë në zgjedhjet vendore"

Valentina Madani

Ambasadori i OSBE-së në Tiranë, Bernd Borchardt, shprehu dje shqetësimin se Shqipëria është duke kaluar një moment kritik. Teksa ishte i pranishëm në një tryezë bashkëbisedimi me kryeprokuroren e përkohshme Arta Marku dhe kreun e KQZ-së, Klement Zguri, ambasadori i OSBE-së u bëri thirrje autoriteteve ligzbatuese që t'i japin zgjidhje çështjes së akuzave për shitblerjen e votës, pasi po vihen në rrezik zgjedhjet. "Shitblerja e votës minon besimin e qytetarëve në zgjedhje. Arritëm bazën e nevojshme për një luftë më të efektshme ndaj manipulimeve zgjedhore si dhe për një pastrim më efikas të listës së kandidatëve nga shkelësit e ligjit apo ata që po hetohen penalisht. Ndërsa në lidhje me dekriminalizimin, partitë politike të duhet të bëjnë kujdes me listat", tha z.Borchardt. Sipas tij: "Autoritetet shqiptare duhet t'i japin prioritet problemit të vazhdueshëm të akuzave të përhapura për shitblerje votash, të cilat kanë cenuar besimin e publikut në zgjedhje. Nevojiten përpjekje serioze nga të gjitha palët për të trajtuar këtë fenomen, ndjekja ligjore e efikasë është një nga mjetet kryesore për luftën ndaj shitblerjes së votës. Jemi duke monitoruar nëse çështjet që denoncohen në prokurori ndiqen vërtetë". Kreu i OSBE-së në Tiranë i bëri thirrje opozitës që të marrë pjesë në zgjedhjet lokale, pavarësisht se parlamentin aktual e cilëson legjitim. Djegia e mandateve nga ana e deputetëve të PD-së e LSI-së nuk i ka shuar ende shpresat e ambasadorit të OSBE-së në Tiranë, Bernd Borchardt, se reforma zgjedhore mund të kalojë në parlament edhe me votat e opozitës së re. Për kreun e Prezencës, një votim i tillë është legjitim, ndonëse ripërsëriti apelin për dialog mes palëve. "Parlamenti është legjitim. Deputetët e rinj si në çdo vend tjetër të botës kanë të drejtë të zgjedhin, por ne inkurajojmë që ata të shkojnë në parlament. Reforma zgjedhore kërkon 84 vota, por ne rekomandojmë dialog politik. Në djetën time nuk është marrë ende vendim nëse opozita nuk do të hyjë në zgjedhje, por sigurisht inkurajojmë pjesëmarrjen e tyre në lokalitete e 30 qershorit", u shpreh z.Borchardt. Ndërsa për reformën zgjedhore, kreu i OSBE kërkon dialog politik.



Prokuroria e Përgjithshme, KQZ dhe OSBE gjatë nënshkrimit të memorandumit për zbatimin e dekriminalizimit

### KËRKESA

"Arritëm bazën e nevojshme për një luftë më të efektshme ndaj manipulimeve zgjedhore si dhe për një pastrim më efikas të listës së kandidatëve nga shkelësit e ligjit apo ata që po hetohen penalisht", tha Borchardt.

### Zëvendësimet, Zguri e Biba debat në komision

## KQZ fut edhe dy deputetë në Kuvend, sot betohen Zeneli e Karamelo

Në parlament sot do të betohen dy deputetë nga lista e Partisë Demokratike, Alban Zeneli dhe Ligoraj Karamelo. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u dorëzoi dje mandatin dy kandidatëve që vendosën të theynin vendimin e opozitës, duke plotësuar formularin e dekriminalizimit. Nga sot KQZ-ja do të nisë të njoftojë kandidatët e tjerë për të marrë mandatin, pasi 14 politikanë në listat e PD-së dhe LSI-së e bënë të qartë se nuk do të bëhen pjesë e parlamentit. KQZ-ja u dha dje mandatin dy ligjvënësve të rinj, çka çon në 14 kartonë numrin e opozitës në parlament. Mandati i Flamur Nokës në Kukës u dha të trettë në listë, Alban Zenelit, ndërsa në Korçë mandati i Salianjit i shkoj Ligoraj Karamelos. Anëtarët e KQZ-së debatuan sërish për radhën e ndjekur në zëvendësimin e listës së PD-së. Denar Biba tha: "Propozimi im është të kalojmë te zoti



Ervin Salianji". Kurse kreu i KQZ-së, Klement Zguri u shpreh: "Qëndroi mendimet që bëme dje debat edhe sot, nuk mund të bësh standard të kësaj natyre. E kuptoj shumë mirë vijën logjike". Biba reagoi sërish: "Pse nuk thua faleminderit që të dhënë mundësinë të votosh ashtu siç dëshiron". Por Zguri u përgjigj: "Unë e di që ju edhe mund t'i lidhni duart që të mos votosh fare. E keni edhe këtë natyrë". Pas debateve mes kryetarit të KQZ-së, Klement Zguri dhe anëtarit Denar Biba për të tejkaluar

rastin e lënies së mandatit nga deputetja Valentina Duka nga PD, pasi dy femrat që i takon mandati i saj nuk kanë kthyer përgjigje, një tjetër deputet i shtohet parlamentit. Ervin Salianji është zëvendësuar kështu nga Ligoraj Karamelo, që ndodhej në listë nën siglën e PBDNJ. KQZ-ja ka njoftuar 14 kandidatët në listën pasuese të PD-së dhe LSI-së, ndërsa formularin e dekriminalizimit deri tani e ka dorëzuar i 11 në listën e LSI-së në Tiranë, Ralf Gjoni.


gun mes deputetëve të rinj dhe mazhorancës, me qëllim që reforma të miratohet, ndërsa i bëri thirrje opozitës që të marrë pjesë në zgjedhjet lokale. Prokuroria e Përgjithshme, KQZ dhe OSBE nënshkruan memo-

randumin e bashkëpunimit për zbatimin e dekriminalizimit. Në këtë memorandum palët angazhohen të mbajnë kontakte dhe të shkëmbejnë informacione intensive gjatë procesit për zbatimin e ligjit. Ndërsa kryetari i KQZ-së,



Ralf Gjoni merr mandatin: Vendim i vështirë

Ralf Gjoni pranoi dje mandatin e deputetit për qarkun e Tiranës. Gjoni, i cili është në listën zgjedhore të LSI-së, dorëzoi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, duke hedhur kështu hapin e parë ligjor drejt marrjes së mandatit të deputetit. Gjoni deklaroi dje për "TCH": "Ky ka qenë ndoshta vendimi më i vështirë politik në jetën time dhe pas një konsultimi të gjerë e të gjatë me familjen time, miq të afërt e kolegë brenda e jashtë vendit, si dhe me votues e aktivistë të shumtë që më kanë mbështetur gjatë fushatës elektorale, kam vendosur të vazhdoj shërbimin tim ndaj agjendës euroatlantike të vendit, e të jem në krahun e drejtë të historisë". Në seancën e radhës, KQZ-ja do të shqyrtojë formularin e tij për t'i dhënë më tej zyrarisht mandatin e deputetit.



Gjatë një seance parlamentare pa opozitën

Vasili: Dosja '339', prova shkatërruese e masakrës ndaj zgjedhjeve

Ish-deputeti i LSI, Petrit Vasili, ngriti shqetësimin se shitblerja e votave në vend ka shkatërruar demokracinë. Në një dalje për mediat nga selia e LSI-së, Vasili nuk i kurseu as akuzat në drejtim të qeverisë. Sipas tij, e vetmja palë që nuk ka ngritur shqetësim për shitblerjen e votës është mazhoranca, pasi është e vetmja që ka përfutuar nga ky fenomen. Vasili njoftoi se opozita do të vijojë me denoncimet ndaj shitblerjes së votës, ndërsa theksoi se dosja '339' ka zbardhur gjithçka. "Kryeministri i prodhuar me votat e kriminelëve në 2017-ën nuk pati asnjë lloj pretendimi për zgjedhjet dhe shitblerjen e votës, sepse ishte frymëzuesi dhe përfutuesi i vetëm i saj. OSBE-ODIHR e ka vlerësuar se zgjedhjet janë vjedhur e këtu mbytet liria politike. Dosja '339' është një turp për atë, se në këtë vend kriminelët kanë vendosur për gjithçka", deklaroi z.Vasili.

Klement Zguri, u bëri thirrje institucioneve që të zbatojnë ligjin e dekriminalizimit pa kompromis. Kryeprokuroerja Arta Marku garantoi hetimin me përparësi të të gjitha çështjeve që prekin integritetin e zgjedhjeve.



Arllind Gjokutaj prezantoi raportin e vitit 2018 për Komisionin e Sigurisë

# Pastrimi i parave, 43 milionë euro të sekuestruara në vitin 2018

Gjatë një viti janë verifikuar 4552 persona të dyshimtë

Shqipëria vijon të mbe-  
tet një nga vendet më  
të preferuara për  
pastrimin e parave të pista.  
Këtë e tregon edhe fakti se  
gjatë vitit 2018, Drejtoria e  
Përgjithshme e Parandalimit  
të Pastrimit të Parave ka  
mundur të sekuestrojë 32.8  
milionë euro nëpërmjet lloga-  
rive bankare dhe 9.5 milionë  
euro të tjera si asete në  
ndërtim apo në natyra të  
tjera. Të dhënat i ka bërë të  
ditura drejtori i Drejtorisë së  
Përgjithshme të Parandalimit  
të Pastrimit të Parave, Ar-  
llind Gjokutaj gjatë raportim-  
it në Komisionin e Sigurisë  
mbi veprimtarinë e këtij in-  
stitucionit përgjatë vitit 2018.  
Sipas tij, "asetet e sekuestru-  
ara në total janë 9.5 mln euro.  
Janë 32.8 mln euro të sekue-  
struara gjatë 2018-ës të  
bllokuara nga llogaritë bank-  
kare, ndërsa u verifikuan 4552  
persona", - bëri të ditur  
Gjokutaj. Sa i përket bash-  
këpunimit me autoritet dogan-  
nore, Gjokutaj theksoi mes  
institucioneve ka një bash-  
këpunim me tendencë në  
rritje. "Dërgim prej tyre i një  
numri të qëndrueshëm ras-  
tesh të dyshimta (49 në vitin  
2018, kundrejt 46, një vit më  
parë)", - tha ai. Gjokutaj vlerë-  
soi edhe bashkëpunimin me  
autoritetet doganore, ku si  
rrjedhojë e sinjalizimit të tyre  
është rikuperuar një shumë e  
konsiderueshëm lekësh në fa-  
vor të shtetit. "Gjithashtu,  
vlen të përmendet bashkëpun-  
imi me autoritet tatimore.  
Nga rastet e sinjalizuara nga



Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Arllind Gjokutaj, dje në Komisionin e Sigurisë

rikuperuar nga Drejtoria e  
Tatimeve 34.4 mln lekë nga të  
dhënat që ka dërguar drejto-  
ria jonë. 7 raste janë dërguar  
për kallëzim penal. Ka ende  
vend për forcimin e  
mbikëqyrjes. Bashkëpunimi  
me ndërkombëtarët është  
shumë pozitiv", - theksoi  
Gjokutaj para deputetëve të  
mazhorancës në komision.  
Ndërsa ka deklaruar se  
lojërat e fatit ishin një tjetër  
aktivitet ku rreziku i pastrim-  
it të parave ishte shumë i lartë,  
duke shtuar se pavarësisht se  
me ligj ky aktivitet ndalohej  
monitorimi i nga kjo drejtori  
nuk është ndaluar: "Vazhdojmë  
monitorimin. Ka pasur raste  
kur janë njoftuar policia për  
transaksione të paligjshme të  
lojërave të fatit dhe ka pasur  
veprime konkrete", - theksoi  
Gjokutaj. Përrapa deputetëve  
të Kuvendit, drejtori DPPP  
theksoi se ndërtimi është sek-  
tori me rrezikshmërinë më të  
lartë për këtë aktivitet të  
paligjshëm. "Sektori i  
ndërtimit është një nga ata  
sektorë me rrishtje më të lartë  
për pastrimin e parave. Jo më  
kot numrim në të lartë të sub-  
jekteve për të cilat ka pasur  
masa kanë qenë pikërisht firmat  
e ndërtimit", theksoi  
Gjokutaj. Ai u shpreh se viti  
2018 ka qenë një vit sfide për  
DPPPP, për shkak të an-  
gazhimit në procese të rëndë-  
sishme si, vlerësimi nga Kom-  
iteti Moneyval, përfshirja  
dhe kontributi i dhënë në  
disa Task-Forca e plane vepr-  
imi, rritja e volumit të anal-  
izës së rasteve të dyshimta.

## Siguria në burgje, ndryshon trajtimi i të burgosurve sipas rrezikshmërisë

Shqipëria numëron aktualisht rreth 5500 të burgo-  
sur që vuajnë dënimet e tyre në afro 20 burgje apo qen-  
dra të tjera të vuajtjes së dënimit. Por, shpeshherë siguria e  
tyre ka lënë për të dëshiruar, ndërsa nuk kanë munguar  
edhe rastet e arratisjes. Ndaj Ministria e Drejtësisë ka ndër-  
marrë nismën për ndryshimin e ligjit "Për të drejtat dhe  
trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".  
Në këtë draft parashikohet ndër të tjera edhe trajtimi i difer-  
encuar i të dënuarve, në varësi të sigurisë së institucionit  
të vuajtjes së dënimit. Diferencimi është i nevojshëm me  
qëllim realizimin e funksionit riedukues të dënimit, si edhe  
rrezikshmërisë që paraqet i dënuari. Diferencimi në tra-  
jtimin e të dënuarve do të përcaktohet në këtë ligj, në Rreg-  
ulloren e Përgjithshme të Burgjeve dhe rregulloret e  
brendshme të çdo institucioni. Nisur nga kjo procedurë, në  
këtë projektligj parashikohet që të burgosurit të ndahen  
në disa kategori sipas veprave penale që ata kryejnë dhe  
rrezikshmërisë që paraqesin. Burgjet, mbi bazën e katego-  
risë që akomodojnë, ndahen në: a. Institucionet e ekzekutim-  
it të vendimeve penale për të dënuarët e rritur; b. Institucio-  
net e ekzekutimit të vendimeve penale për të dënuarët e  
mitur; c. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale  
për gratë; ç. Institucionet e paraburgimit.

### BIE NUMRI I RASTEVE TË REFERUARA

Deputetët kërkuar të informohen me faktin se pse numri  
i rasteve të kallëzuar në Prokurorinë e Përgjithshme  
është me i ulët se në vitet e shkuara. "Është e vërtetë që  
numri i referimeve në prokurori ka pasur rënie, sepse  
synimi ynë si njësi inteligjence ka qenë me policinë, që  
pasi të plotësohen nga policia, të dërgohen drejt organit  
të prokurorisë. Kemi synuar që të plotësojmë më tepër  
në detaje informacionin. 31 raste në 2017, 17 raste në  
2018. Po ti marrim në konsideratë këto dy vite me ato të  
mëparshmet është më i lartë", tha Gjokutaj.

DPPPP janë dërguar në total  
17 raste për vlerësim tatimor  
dhe vlera e dyshuar si e pade-  
klaruar është 482 milionë lekë,  
nga të cilat janë dërguar 7 ras-  
te për kallëzim penal", - u  
shpreh ai. Gjithashtu, ai evi-  
dencoi edhe rritjen e bash-  
këpunimit të DPPPP me orga-  
net e zbatimit të ligjit dhe ato  
të inteligjencës. "Viti 2018  
shënoi një rritje me 10% të

rasteve të dyshimta që subjek-  
tet e ligjit kanë raportuar në  
DPPPP krahasuar me 2017", -  
u shpreh Gjokutaj. Drejtori  
Gjokutaj gjatë fjalës së tij  
vlerësoi bashkëpunimin me  
SHISH si edhe ndërkombëtarët  
në goditjen e fenomenit.  
"Bashkëpunimi me SH-  
ISH, shumë efektiv për paran-  
dalimin e pastrimit të parave  
dhe terrorizmit. Në 2018 janë


## Kanë lodhje fizike, qeveria projektligj që largon policët mbi 50 vjeç

Ministria e Drejtësisë  
ka përgatitur një pa-  
ketë projektligjesh që  
kërkojnë të rregullojnë  
marrëdhëniet dhe situatën  
në sistemin e burgjeve në  
vend. Një prej projektligjeve  
të hartuar tashmë është  
edhe ai "Për Policinë e  
Burgjeve", ku paralajmëro-  
hen largime të punonjësve  
të saj. Sipas këtij drafti,  
parashikohen largime dhe  
rifiksim të stafit të poli-  
cisë, por edhe përcaktimin e  
kategorive të rekrutimit dhe  
të trajtimit të të mirë të  
tyre. Kështu do të ketë lar-  
gime të atyre punonjësve të  
Policisë së Burgjeve që janë  
në moshën mbi 50 vjeç për  
faktin se nuk u përgjigjen



kërkesave të punës. Në rela-  
cionin e projektligjit bëhet e  
ditur se "problematikat lid-  
hen së pari me nivelin jo të  
kënaqshëm të performancës  
së punonjësve të policisë së  
burgjeve, që lidhet me rek-  
rutimin, trajtimin ekonomik  
e financiar, kualifikimin, pro-  
movimin dhe mbështetjen e  
tyre. Menaxhimi i deritan-  
ishëm nuk garanton një bal-

ancë, ndërmjet kërkesave  
për përmirësimin e shër-  
bimit publik dhe respek-  
titimit të të drejtave të  
punonjësve". Gjithashtu,  
në relacion theksohet se:  
"Procedurat aktuale dhe si-  
tuata në të cilën ndodhen  
punonjësit e Policisë së  
Burgjeve ka sjellë vështirë-  
si në rekrutimin e punon-  
jësve cilësor dhe prezencën  
e një numri të konsideru-  
eshëm të punonjësve me  
moshë mbi 55 vjeç, gjë që sjell  
vështirësi në kryerjen e  
detyrave që kanë lodhje fizike.  
Numri i punonjësve të  
policisë së burgjeve, mbi 50  
vjeç është 24.7%", thuhet në  
relacionin që shoqëron këtë  
projektligj.



**EMBASSY OF THE STATE OF QATAR**

**NJOFTIM PUNËSIMI**

**AMBASADA E SHTETIT TË KATARIT NË TIRANË KËRKON TË PUNËSOJËT:**

1. Sekretare ekzekutive
2. Përkthyes të gjuhës arabe
3. Hulumtues ekonomik

**Kriteret:**

- Sekretarja ekzekutive duhet të ketë njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze dhe përvojë në administrim zyre.
- Përkthyesi të jetë specialistuar në këtë fushë dhe të ketë njohuri të shkëlqyera të gjuhës arabe.
- Hulumtuesi ekonomik të ketë formim arsimor në ekonomi dhe përvojë profesionale në fushën e tij
- Njohjen e gjuhës arabe dhe angleze.

**Kritere të përbashkëta:**

- Eksperiencë në pozicionin e kërkuar,
- Shkolla e lartë e sipër
- Të jenë të motivuar
- Të artikulojnë dhe në lartësinë e detyrave që iu ngarkohen,
- Njohje e programeve bazë kompjuterike.

Posta elektronike për dorëzimin e aplikimit  
(e-mail): [hr\\_embassyqatar@yahoo.com](mailto:hr_embassyqatar@yahoo.com), Tel: +355(4)2274579

Ministria e Financave flet për herë të parë në emisionin "Dritare me Rudinën" në "News 24"

# Anila Denaj: Kufizojmë koncesionet PPP

"Sali Berisha më quan Madam Falimenti? Fjala madam më pëlqen"

Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Anila Denaj, tha se nga 1 korriku 2019, me anë të ligjit të ri nuk do të jetë më e mundur të propozohen nga sektori privat projekte koncesioni/PPP. E ftuar në emisionin "Dritare me Rudinën" në "News 24", Denaj u shpreh se aktualisht janë 11 oferta të pakërkuaara për PPP, ndërsa me ligjin e ri do të ketë limitim dhe monitorim të PPP-ve.

Janë 11 oferta të pakërkuaara dhe janë investime në infrastrukturë dhe në shkolla, spitale. Këto janë shërbime publike që vijnë për PPP-ve. Disa shërbime janë të domosdoshme. Roli i Ministrisë së Financave parashikon që të jetë kyç në monitorim. Më parë ky proces nuk ishte i parashikuar. Ky rol vjen i shtuar me ligjin e ri për PPP-të. Ligji i ri ka disa avantazhe, se bën një limitim të PPP-ve dhe e lë atë të hapur vetëm për disa sektorë të caktuar. Kërkohej një monitorim më i mirë i PPP-ve dhe shërbimet mendoj se vijnë më shpejt", - tha ministria Denaj.



## MONITORIMI

Ligji i ri ka disa avantazhe, se bën një limitim të PPP-ve dhe e lë atë të hapur vetëm për disa sektorë të caktuar. Kërkohej një monitorim më i mirë i PPP-ve dhe shërbimet mendoj se vijnë më shpejt", - tha ministria Denaj.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Anila Denaj, dje në emisionin "Dritare me Rudinën" në "News 24"

## INVESTIMET

"Rritja e ekonomike është një proces zinxhir dhe kur veprojmë, duhet të kemi parasysh që çfarë jemi duke bërë. Numri i turistëve është rritur vitin e kaluar. Nëse flasim për muajin shkurt, i cili është muaji që bëhen rezervime nga turistët dhe një ditë të shtunë shfaqen skena që thuhet në mediat e huaja se nuk ka siguri, atëherë kjo ndikon në anulimin e këtyre rezervimeve.

pasiguri ekonomike. Mendoj se do të tejkalohen", - tha Denaj.

## KRIZA POLITIKE

Anila Denaj pranoi se kriza politike dhe protestat e opozitës ndikojnë që investitorët e huaj të stepen.

Ministria tha se ka pasur anulime të rezervimeve nga turistët e huaj gjatë muajit shkurt në hotellet e bregdetit shqiptar. "Rritja e ekono-

mike është një proces zinxhir dhe kur veprojmë, duhet të kemi parasysh që çfarë jemi duke bërë. Numri i turistëve është rritur vitin e kaluar. Nëse flasim për muajin shkurt, i cili është muaji që bëhen rezervime nga turistët dhe një ditë të shtunë shfaqen skena që thuhet në mediat e huaja se nuk ka siguri, atëherë kjo ndikon në anulimin e këtyre rezervimeve. Ka pasur anulime të

këtyre rezervimeve. Samiti i Diasporës tregoi se edhe bashkatdhetarët tanë kanë dëshirë të investojnë në Shqipëri. Investitorët e huaj marrin kohën e duhur. Niset me njohjen e potencialeve, lehtësive fiskale. Gjithashtu, ata shohin infrastrukturën dhe proceset në këtë drejtim janë duke avancuar. Investitorët shohin se si është klima e biznesit", - tha ministria.

## PËRGJIGJA NDAJ BERISHËS

Denaj i është përgjigjur ish-kryeministrit Sali Berisha, i cili e quajti "Madam Falimenti" sapo mori detyrën si ministër.

**Rudina Xhunga: Mesa duket, edhe ish-kryeministri Berisha ta pranon faktin e të qenit profesioniste e fushës, vetëm që nuk të quan ndrikull, të quan 'Madam Falimenti'.**

**Anila Denaj:** Fjala madam është e bukur, por fjala faliment nuk është. E para, sepse nuk mendoj që për tre muaj si drejtuese e Fondit të Sigurimit të Shëndetit Publik arrita ta falimentoj. E dyta është sepse, arsyet e dhëna në komentet e zotit Berisha

janë të lidhura me mospagësa, besoj se ata që e njohin ligjin e buxhetit, i cili u prevalon mbi gjithçka do të më jepnin të drejtë. Megjithatë, unë e vlerësoj edhe fjalën madam, mbetem e kënaqur vetëm me të.

**Pyetje: Në tremujorin e 4 të vitit 2018 papunësia ka shënuar rritje. Cilat janë arsyt që ekonomia nuk po prodhon më rritje të punësimit?**

**Denaj:** Treguesit janë në bazë vjetore. Nuk mund të flitet për tremujorin. Nuk mendoj se nuk ka punë dhe se nuk ka profesionistë. Ka nevojë ende për koordinim. Nuk mund të themi që ka ulje të treguesit. Progresi vjetor edhe me pak pikë përqindje është rënës.

## Përfitojnë 120 mijë nxënës nga programi "Shkollat e shek. 21"

# Qeveria britanike, 10 milionë paund për arsimin në Shqipëri dhe në Ballkan

## MINISTRJA E ARSIMIT

Ministria e Arsimit, Besa Shahini dhe i ngarkuari me punë i ambasadës britanike panë projektet nga 15 shkollat që morën pjesë në konkursin "Shkollat e shekullit 21". Dy fitues do të përfaqësojnë Shqipërinë në një konkurs rajonal në Beograd, në muajin prill.



Qeveria britanike ka vendosur të investojë 10 milionë paund në Shqipëri dhe në 5 vende të tjera në Ballkan për profesionet e së ardhmes. "Shkollat e shekullit 21" është një program ambicioz trevjeçar, i financuar nga qeveria britanike, i cili do t'i pajisë mbi një milion nxënës të moshës 10-15 vjeç në vendet e Ballkanit Perëndimor me aftësi të mendimit kritik, zgjidhjes së problemeve dhe kodimit. Ai synon të rrisë brezin e ardhshëm të novatorëve dhe sipërmarrësve, si dhe të ndërtojë mundësi punësimi. Të gjitha shkollat e arsimit bazë në Shqipëri si dhe në Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoni e Veriut dhe Serbi do të pajisen

me pajisje micro:bit (mikro-komputerë portabël), të cilat do t'u ndihmojnë fëmijëve të mësojnë aftësi të reja digjitale dhe koduese në një mënyrë zbavitëse dhe ndërvepruese. Ndërsa shoqëria shqiptare përballlet me përfitimet dhe sfidat e nxitura nga teknologjia dhe no-

vacioni, ky program trevjeçar synon t'i përgatisë brezat e rinj me mendësinë dhe aftësitë për profesionet e së ardhmes. Në Shqipëri, rreth 1,200 shkolla, më shumë se 4,000 mësues dhe rreth 120,000 nxënës, mes moshës 10-15 vjeç janë përfshirë në program. Në aktiv-

itetin e lançimit në Tiranë, në shkollën "Niket Dardani", përfaqësues nga "British Council", qeveritë shqiptare dhe britanike si dhe nga institucione të tjera diskutuan sfidën e pajisjes së nxënësve në Shqipëri dhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor me aftësitë e së

ardhmes. Sir Alan Duncan, ministër për Evropën, tha në një mesazh video: "Në emër të qeverisë britanike dhe të 'British Council' jam shumë i gëzuar që lançojmë programin 'Shkollat e shekullit 21' në Ballkanin Perëndimor, sot në përvjetorin e 30 të shpikjes së internetit".

Angus Bjarnason, drejtor i 'British Council' për Shqipërinë tha se, "tani me mbështetjen bujare të qeverisë britanike do të jemi në gjendje të shtrijmë këtë program në çdo shkollë të arsimit bazë dhe në çdo komunitet nëpër Ballkanin Perëndimor".

Kreu i ALUIZNI-t: Rrugë që duhet të ndjekin banorët për të marrë lejet e legalizimit

# Pallatet e braktisura, Lame: Legalizuam 10 400 apartamente

## Kategoritë që përfitojnë nga ndryshimet në ligj

**A**LUIZNI ka përfunduar procesin e leglizimit dhe pajisjen me leje për 10 400 apartamente në kryeqytet, ndërtuesit e të cilëve kishin braktisur punën pa u dhënë tapinë banorëve që kishin blerë shtëpitë. Ndërkohë, banorët e pallateve që s'kanë marrë ende tapitë për shtëpitë e tyre duhet të bashkohen të zgjedhin një përfaqësues, i cili më pas të ndjekë të gjitha procedurat për legalizim me punonjësit e ALUIZNI-t. Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame, bëri të ditura shifrat e lejeve të dhëna deri tani dhe procedurat që duhet të ndjekin banorët gjatë një takimi me banorët e një pallati të braktisur, i cilët tashmë kanë përfunduar të gjitha procedurat që kërkon ligji për pajisjen me leje legalizimi. "Procesi i legalizimit të pallateve të braktisura është një prej proceseve më të komplikuar pronësore, për shkak të shtrirjes në kohë të fenomenit, të konflikteve të trashëguara mes pronarëve të trojeve, të ndërtesave dhe vetë banorëve, për shkak të mungesës së dokumentacionit, të mosmarrveshjeve mes vetë banorëve e kështu me radhë. Megjithatë, falë impenjimit të strukturave dhe bashkëpunimit të banorëve, deri tani vetëm në Tiranë është bërë e mundur të legalizohen rreth 140 pallate të tilla me rreth 860.000 m<sup>2</sup> ndërtim dhe 10.400 apartamente dhe njësi shërbimi", - tha Lame.



Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame


**APLIKIMI**

Banorët e pallateve që s'kanë marrë ende tapitë për shtëpitë e tyre duhet të bashkohen të zgjedhin një përfaqësues, i cili më pas të ndjekë të gjitha procedurat për legalizim me punonjësit e ALUIZNI-t. Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame, bëri të ditura shifrat e lejeve të dhëna deri tani dhe procedurat që duhet të ndjekin banorët gjatë një takimi me banorët e një pallati të braktisur, i cilët tashmë kanë përfunduar të gjitha procedurat që kërkon ligji për pajisjen me leje legalizimi.

fuqi të Ligjit për Kadastrën, fillon sfida e madhe e qeverisë shqiptare për të reformuar të gjithë sistemin e regjistrimit të pronës". Administratorja e pallatit, e cila ishte personi që merrte kontakt me Drejtorinë e ALUIZNI-t, tha se: "Ishte e vështirë që t'i bëja bashkë të gjithë banorët, por kur të gjithë u bindën për të plotësuar doku-

mentet, procesi mori fund brenda shumë pak kohësh". Lame gjeti rastin për të thënë se termi Hipotekë nuk do të ekzistojë më me hyrjen në fuqi të ligjit të Kadastrës. Pallati i legalizuar ka marrë lejen e ndërtimit më datë 07.06.2008 nga Bashkia Tiranë. Nuk është pajisur me leje shfrytëzimi, pasi ndërtuesi ka realizuar shtesa anë-

sore tej lejes së ndërtimit. Subjekti ndërtues nuk ka paraqitur deklarin për legalizim për pallatin dhe pas njoftimit të kryer nga ALUIZNI, nuk i është përgjigjur për vazhdimin e procedurave. Në këtë mënyrë, ALUIZNI ka vijuar me procedurat e legalizimit në emër të banorëve sipas përcaktimeve të VKM-së 19, të 2017.



### Tatimet: Transaksione me para në dorë, ja kur gjobiteni

**D**rejtoria e Përgjithshme e Tatimeve u kujton ta timpaguesve se mund të kryhen transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë deri në shumën 150 mijë lekë. Transaksionet mbi këtë shumë duhet të kryhen detyrimisht në rrugë bankare. Në rast se vlera e transaksionit me para në dorë është më e madhe se kjo shumë, atëherë ligji parashikon penalitet në masën 10% të vlerës së secilit transaksion. "Ky dënim do të zbatohet si për blerësin, edhe për shitësin, nëse të dy janë persona juridikë dhe/ose fizikë tregtarë dhe blerësi ka paguar direkt shitësin me para në dorë", shpjegon Tatimet. Por, edhe në rast se blerësi ka paguar me para në dorë në llogarinë bankare të shitësit, dënimi zbatohet vetëm ndaj blerësit. Ashtu sikurse nëse shitësi i autorizuar nga blerësi, për likuidimin e transaksionit ka tërhequr me para në dorë nga llogaria bankare e blerësit, dënimi zbatohet ndaj shitësit.



**MASA**  
"Ky dënim do të zbatohet si për blerësin, edhe për shitësin, nëse të dy janë persona juridikë dhe/ose fizikë tregtarë dhe blerësi ka paguar direkt shitësin me para në dorë"

## Rritja e çmimit të ujit, në proces 11 ujësjellës Peleshi: Të krijojnë të ardhura nga mirëmenaxhimi

**P**lot 11 shoqëri të ujësjellës-kanalizimeve kanë aplikuar për rritje tarifash pranë Entit Rregullator të Ujit, ndërkohë që kreu i këtij institucioni, Ndrçim Shani, thotë se priten edhe të tjerë. Sipas kreut të ERRU-së, në shumë qytete ka hapësira për rritje tarifash, por kreu i Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, Niko Peleshi ka kërkuar që kompanitë të mirëmenaxhohen për të përmirësuar situatën financiare, duke e parë si hallkë të fundmi është sanksionuar në një rregullore të re të nxjerrë për konsultim nga Enti Rregul-

**KEREKSAT**  
Niko Peleshi ka kërkuar që kompanitë të mirëmenaxhohen për të përmirësuar situatën financiare, duke e parë si hallkë të fundmi është sanksionuar në një rregullore të re të nxjerrë për konsultim nga Enti Rregul-

lator i Energjisë (ERRU). Projektregullorja është e zbatueshme nga të gjitha subjektet e licencuara nga Enti Rregullator i Ujit. Kështu, çdo kërkesë që depozitohet pranë ERRU do të mer-



ret në shqyrtim nga Komisioni Kombëtar Rregullator, ndërkohë që çdo ankimum do të duhet të jetë i shoqëruar me numrin e ankimitit, datën e dorëzimit, objektin e ankimitit, numrin dhe emërtimin e dokumenteve që i bashkëngjiten ankimitit dhe identitetit bashkë me adresën e ankimuesit. "Në varësi të objektit të ankimit dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjësishtë të diskrecionit, komisioni cakton një afat të arsyeshëm për përfundimin e procedurës administrative, i cili në çdo rast nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë nga data e njoftimit të komisionit për pranimin e ankimit. Zgjatja e afatit të procedurës administrative përtej kufirit të përcaktuar nga ligji nr. 44/2015 mund të bëhet nga komisioni në raste të justifikuar, për shkak të kompleksitetit të çështjes. Zgjatja e afatit nga Komisioni mund të bëhet vetëm një herë dhe bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar", thuhet në dokument.

**SHPLLJE ANKANDI**  
Zyra Përmbarimore "E.G Ballif Service" me përmbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvoja, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 08.04.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i III-të për shitjen e pasurisë së paluajtshme. Apartament me sipërfaqe totale 45.3 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 5628+1-26, Vol.13, Fq.41, Zk-3976 në pronësi të Hipotekuesit shoq. Sina Konstruksion 2008 sh.p.k me adresë Skoczi, Tiranë me vlerë fillestare në ankand 9,132.48 (Nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e dy pikë dyzet e tetë) EURO dhe Apartament me sipërfaqe totale 63.3 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 5628+1-26, Vol.13, Fq.42, Zk-3976 në pronësi të Hipotekuesit shoq. Sina Konstruksion 2008 sh.p.k me adresë Skoczi, Tiranë me vlerë fillestare në ankand 12,761.28 (Dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë njëzet e tetë) Të interesuar të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888, email enuar.merko@gmail.com

**Ngjarja në prill të 2016-ës, ja provat ndaj 35-vjeçarit**

**Mbyti gruan e pronarit me porosi të tij, dënohet me burgim të përjetshëm Fatjon Karmeshtna**

**TIRANË** - Fatjon Karmeshtna është dënuar dje me burgim të përjetshëm nga Gjykata për Krime të Rënda pasi akuzohet për vrasjen e Suela Sulës, ngjarje kjo e ndodhur afro tre vite më parë në Shkodër. Pas një sërë seancash gjyqësore, 35-vjeçari është shpallur fajtor për mbytjen me duar në fyt të nënës së tre fëmijëve, me porosi të bashkëshortit të saj, Sadetin Sula. 38-vjeçarja, u gjet e pajetë në tualetin e mobilierisë që kishte ajo dhe burri. Biznesmeni Sadedin Sula akuzohet për "vrasje me dashje, për shkak të marrëdhënieve familjare për arsye xhelozie". Vrasja, që u cilësua më parë si vetëvrasje, u krye nga Fatjon Karmeshtna me urdhër të Sadedin Sulës. Gjatë gjyqimit, prokuroria solli prova, të cilat faktinin se Karmeshtna është personi



35-vjeçari, Fatjon Karmeshtna

që ka mbytur viktimën. Prova kryesore ishte analiza e ADN-së, që faktoi se 36-vjeçari ishte autor i krimit të rëndë. Në thonjtë e viktimës u gjetën mbetje, të cilat u krahasuan me ato të të pandehurit, të cilat përputheshin plotësisht.

Provë tjetër mbi të cilën u bazua gjykata ishte dhe një regjistrim audio i bërë nga telefoni i viktimës. Në atë material dëgjohej Sadedin Sula duke i thënë Karmeshtnës se kishte dyshime se e shoqja e tradhtonte. Sipas tij,

ajo do të ndahej me të dhe do t'i merrte gjysmën e biznesit. Fatjon Karmeshtna ishte punëtor në mobilieri dhe shërrëri i fundit mes çiftit Sula kishte qenë pikërisht ai, pasi Sula i kishte kërkuar bashkëshortit ta largonte nga puna. Provë tjetër mbi të cilën u bind gjykata për të dhënë këtë dënim kapital ishin edhe dëshmitë e fëmijëve të viktimës, të cilët treguan se shpesh ata dhunoheshin nga babai i tyre.

**NGJARJA**

Suela Sula u gjet e pajetë më 18 prill të vitit 2016, në orën 12:30, në fshatin Melgushë të Shkodrës. Trupi i saj u gjet në tualetin e mobil-



Bashkëshortët Sadetin dhe Suela Sula

ierisë, në të cilën viktimja ishte bashkëpronare. Ajo ishte shoqëruar në punë nga bashkëshorti i saj, Sadetin Sula, i cili më pas është kthyer në qytetin e Shkodrës. Si fillim rasti ishte konsideruar si vetëvrasje, por ekspertët mjekoligjorë arritën në konkluzionin se ajo ishte mbytur me duar nga një person. Më datën 7 prill 2017, nën

akuzë u vu Sadetin Sula, i cili akuzohet për "vrasje me dashje për shkak të marrëdhënieve familjare". Motivi i vrasjes dyshohet se ka qenë xhelozia. Por në zbulimin e mënyrës se si u krye krimi ndihmuan tabulatet telefonike. Nga to rezultoi se Sadedin Sula fliste shpesh me punëtorin Karmeshtna për gruan e tij dhe xhelozinë.

"Mos e vrit mendjen Floro, më 16 mars ikën, do të thyejmë burgun"

TIRANË

Gjykata e Apelit e Tiranës la dje në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për 19 personat e arrestuar në kuadër të protestës opozitare të 16 Shkurtit. Trupa gjyqësore la në burg 5 protestues, 8 në arrest shtëpie dhe 6 në detyrim paraqitje. Konkretisht negelen në burg ish-kreu i Policisë Bashkiake, Florenc Hoxha, Ilir Hamedani, Saimir Rexhepi, Agim Peposhi dhe Ferit Dankshi. Gjatë seancës së djeshme, Gjykata nuk pranoi ankimimin e avokatëve të protestuesve me pretendimin se ato duhet të ishin firmosur nga personat që ishin nën hetim. Nga ana e saj Prokuroria thotë se vendimi i Shkallës së Parë është i padrejtë dhe duhet prishur, pasi nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë nuk janë vlerësuar drejt provat, pasi protestuesit kanë qenë aktivë në kryerjen e akteve të dhunës ndaj godinës së kryeministrit. Për 11 protestuesit të cilët janë nën masën e sigurisë, "arrest shtëpie" apo "detyrim paraqitje" prokuroria paraqiti ankim dhe kërkoi kthimin e tyre në burg. Të arrestuarit akuzohen për veprat penale: "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik", "Goditje për shkak të detyrës", "Shkatërrimi i pronës" dhe "Prishja e qetësisë publike". Ndërkaq, vendimi i Gjykatës së Apelit për të lënë në fuqi të njëjtën masë si Gjykata e Shkallës së Parë për 19 protestuesit e arrestuar pas protestës së 16 Shkurtit para Kryeministrit ka irrituar familjarët dhe disa prej të akuzuarve me masën "detyrim paraqitje". Në sallë pati thirrje "Poshtë Edi Rama". Ndërsa, në një video të siguruar nga

**Protesta e 16 shkurtit para Kryeministrit, Apeli lë në burg Florenc Hoxhën e 4 të tjerë**

*Të akuzuarit dhe familjarët e tyre rebelohen në sallën e gjyqit: Poshtë komunistët!*



Protesta e opozitës

"News 24", duket qartë momenti kur të akuzuarit dhe familjarët dalin nga dyert e gjykatës dhe thonë se do të protestojnë sërish më 16 mars. Ata dëgjohej duke thënë: "Poshtë komunistët", "Mos e vrisni mendjen, më 16 mars do thyejmë burgun". Më 16 mars opozita ka paralajmëruar mbajtjen e një proteste para kryeministrit, përmes së cilës, njëjtë si edhe në tubimet e tjera, kërkojnë rrëzimin e qeverisë Rama, krijimin e një qeverie tranzitore për ta çuar vendin në zgjedhje të parakohshme. Me deklarata të tilla të personave që do të jenë në protestën e 16 marsit, mund të hidhen sinjalet e para se protesta do të jetë sërish e dhunshme.

trisë, përmes së cilës, njëjtë si edhe në tubimet e tjera, kërkojnë rrëzimin e qeverisë Rama, krijimin e një qeverie tranzitore për ta çuar vendin në zgjedhje të parakohshme. Me deklarata të tilla të personave që do të jenë në protestën e 16 marsit, mund të hidhen sinjalet e para se protesta do të jetë sërish e dhunshme.

**MASAT E SIGURISË DHËNË NGA GJYKATA E APELIT TIRANË PËR 19 PROTESTUESIT**

1. Florenc Hoxha, arrest me burg
2. Ilir Hamedani, arrest me burg
3. Saimir Rexhepi, arrest me burg
4. Agim Peposhi, arrest me burg
5. Ferit Dankshi, arrest me burg
6. Emanuel Nallbani arrest shtëpie
7. Naim Haxhiu arrest shtëpie
8. Andon Gjini arrest shtëpie
9. Resul Daci arrest shtëpie
10. Suzana Dimushi detyrim paraqitje
11. David Linadi arrest shtëpie
12. Festim Taku arrest shtëpie
13. Mitat Fieraku detyrim paraqitje
14. Lefter Jakupi detyrim paraqitje
15. Pellumb Shelna detyrim paraqitje
16. Velion Dine arrest shtëpie
17. Ndue Tuci arrest shtëpie
18. Shpresa Lini detyrim paraqitje
19. Hasan Jakupi detyrim paraqitje

**Protestuan kundër Ramës në Fier, gjykata liron 4 të arrestuarit**

**FIER** - Gjykata e Fierit ka liruar 4 të arrestuarit për protestën e së shtunës, në të cilën u shënuan përplasjet mes policisë e banorëve që kishin dalë për të protestuar kundër kryeministrit Edi Rama. Në seancën e djeshme, togat e zeza vendosën masën e sigurisë "detyrim paraqitje" për Behar Xhelon, Besnik Jaupajn, Gëzim Ballën si edhe Hysen Hoxhën, të cilët u arrestuan nga policia me akuzën "Pëngimi i qarkullimit të mjeteve të transportit" dhe "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme". Lidhur me protestën u proceduar penalisht në gjendje të lirë 41 protestues. Seanca gjyqësore u zhvillua nën masë të rrepta sigurie. Gjykata e Fierit u rrethua me kordon policie, ndërsa kreu i PD në këtë qytet Luan Baçi akuzoi ata se nuk po e lejonin të futej në sallë.



Koncesionari merr abuzivisht tarifë 480 lekë për ton, flasin ndërtuesit

# Landfilli në Sharrë "vjel" paratë publike dhe private

## Taksë e fshehtë për dherat që shkarkohen

Megjithë denoncimet e përsëritura në "Neës 24", kompania koncesionare e landfillit të Sharrës, "Integrated Energy BV", vazhdon t'iu vjelë ndërtuesve taksën e fshehtë për dherat që shkarkojnë në landfill. Kamionët e ngarkuar me dhera vazhdojnë të hyjnë në landfill për t'iu shkarkuar ato duke paguar. Ata dalin sërish nga landfilli, duke treguar faturën e cila vërteton se kanë paguar 480 lekë për çdo ton dhe të shkarkuar. Të njëjtën tarifë paguan edhe Bashkia e Tiranës për shkarkimin e dherave në landfill.

Vetëm nga tarifa që Bashkia e Tiranës i paguan koncesionarit të landfillit të Sharrës, në një vit "Integrated Energy B.V" ka përfituar gati 11 mln \$. Sipas të dhënave të përpunuara nga "Open Data Albania" rezultoni se Bashkia e Tiranës gjatë periudhës janar 2018-janar 2019 ka kryer gjithsej 28 transakcione me landfillin. Në përshkrimin e faturave të publikuara nga thesari nuk përcaktohet shuma që Bashkia e Tiranës i paguan koncesionarit për çdo mbetje organike apo edhe tarifa ekstra që paguhet për dherat e depozituara në landfill. Në përshkrimin e faturave mujore përshkruhet vetëm depozitimi i mbetjeve urbane për ndërtim landfilli, incenerator dhe rehabilitim.

Prej më se shtatë muajsh ndërtuesit, shoqatat mjedisore dhe shoqatat e biznesit denoncojnë tarifat abuzive



Landfilli i Sharrës

### REAGIMET

Ndërtuesit vazhdojnë ta cilësojnë një vendim korruptiv, skandaloz dhe të padrejtë, vendimin për tarifën që duhet t'i paguajnë koncesionarit "Integrated Energy B.V" në landfillin e Sharrës për çdo ton dhe, që janë të detyruar të shkarkojnë në të.



që landfilli i Sharrës iu merr për çdo kamion me dhera që depozitohen në Sharrë. Ata e cilësojnë këtë vendim me natyrë klienteliste dhe kor-

ruptive. "Ne kemi kundërshtuar e kemi për gatitur do ta çojmë në Gjykatë Kushtetuese, sepse në çdo hap që bëhet është shkelje e hapur",

shprehet Luigj Aleks. "Si një vendim me natyrë klienteliste dhe korruptive", thekson Bregasi. "Është rasti i parë në Shqipëri që dherat

### KONCESIONARI

Koncesionari i inceneratorit të zonës së trajtimit të mbetjeve në Sharrë ka caktuar një tarifë 480 lekë/ton, për çdo mjet që shkarkon dhera apo mbetje ndërtimore, ndërkohë që merr nga bashkia 29 euro për çdo ton mbetje organike, të prodhuar nga banorët e kryeqytetit.

### SHKURT

**Sekuestrohen 31 kg drogë në Patos, përfundojnë në pranga babë e bir**

**FIER** - Policia e Fierit ka vënë në pranga babë e bir, ndërsa ka sekuestruar 31 kg kanabis. Në pranga kanë përfunduar shtetasit me inicialet: B.G, 51 vjeç dhe A.G, 27 vjeç, banues në Patos. Sipas bluve, sasia e lëndës narkotike u gjet e fshehur në shtëpinë e tyre në kuadër të operacionit të koduar "Lënginas". Gjithashtu, nga kontrolli i ushtruar në servis in e kasetofonave në pronësi të tyre, u gjetën disa doza me lëndë narkotike kanabis. Materialet procedurale në ngarkim të babë e bir i kaluan për hetime të mëtejshme prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve". Pritet që togat e zeza të këtij qyteti të vendosin masën e sigurisë ndaj tyre.

**Plagosi vajzën me thikë e rrahu djalin, arrestohet 50-vjeçari**

**VLORE** - Një 50 vjeçar nga Vlora për pak sa nuk ka shkaktuar një tragjedi në familjen e tij. Mësohet se shtetasi P.Sh., ka ushtruar dhunë fizike ndaj të birit, ndërsa ka plagosur me thikë në dorë vajzën e tij. Situata mund të kishte qenë edhe më e rëndë, por blutë kanë ndërhyrë duke arrestuar agresorin. "Ndërhyrja në kohë e policisë parandalon një krim në familje. Policia e Vlorës falë ndërhyrjes në kohë ka parandaluar përshkallëzimin e një konflikti familjar me pasoja të rënda. Arrestohet në flagrancë shtetasi P.Sh., 50 vjeç, pasi në banesë, nën efektin e pijeve alkolike, ka ushtruar dhunë fizike ndaj djalit të tij dhe ka plagosur lehtë në dorë me mjete prerëse (thikë) vajzën e mitur", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

## Vrau të riun për gërvishtjen e makinës, lihet në burg autori, Olger Mustafa


**KORÇË** - Gjykata e Korçës caktoi dje masën e sigurisë "Arrest me burg" për Olger Mustafën, i cili vrau për gërvishtjen e makinës 35-vjeçar, Altin Balliu. Mustafaj iu fsheh policisë për disa javë pas ngjarjes. Ndërkohë, prokuroria kërkoi lënie në qeli të autorit të krimit, masë e cila u la në fuqi edhe nga gjykata. Ngjarja për të cilën akuzohet Mustafa ndodhi në një lokal pas një konflikti që ai kishte pasur me viktimën, banor i fshatit Slabinjë të Pogradecit, dhe shokët e këtij të fundit. Mësohet se i gjithë shërr kishte nisur për bllokimin e rrugës me makinë nga shokët e 35-vjeçarit, që mbeti i vrarë. Sipas burimeve nga grupi hetimor autori ka qëlluar fillimisht me një plumb makinën e viktimës. 35-vjeçari ka dalë nga makina, autori e ka ndjekur dhe e ka qëlluar me plumb në kokë duke e lënë të vdekur. Dëshmi-



Ngjarja për të cilën akuzohet Mustafa ndodhi në një lokal pas një konflikti që ai kishte pasur me viktimën, banor i fshatit Slabinjë të Pogradecit dhe shokët e këtij të fundit.

tarët thanë për 'News 24', se ka pasur një sherr masiv në lokal që kanë përfunduar deri në vrasjen e 35-vjeçarit

por ende nuk janë të qarta rrethanat. Trupi i viktimës u gjet nga banorët në mes të një blloku banimi.



## Shkarkohet drejtoresha e Kufirit dhe Migracionit

**DURRËS** - Drejtoresha Rajonale e Kufirit dhe Migracionit në Durrës, Lindita Nushi është shkarkuar nga detyra. Vendimi për shkarkimin e saj vjen disa ditë pas arrestimit të 6 kontrollorëve në Kufirin e qytetit bregdetar. Këta të fundit u lanë të lirë nga gjykata pas arrestimit, ndërsa dyshohet të jenë përfshirë në skema rryshfeti gjatë kohës që ushtronin kontrollin në kufi. Lindita Nushi mbante këtë post që nga maji i vitit të shkuar. Gjykata e Durrësit dha masën e sigurisë 'Arrest shtëpie' me 5 mars për Greta Batusha si dhe masën 'detyrim paraqitje' për Durim Zeka, Arjan Gjyzeli, Dorina Doganaj e Gëzim Çaça. "Gjatë ndjekjes së këtij procedimi janë aplikuar metodat speciale të hetimit, ku rezultoni e provuar veprimtaria e kundërligjshme e këtyre punonjësve të policisë, të cilët, në këmbim të vlerave të ndryshme monetare, bënin të mundur kalimin e paligjshëm të personave me probleme, apo kategorisë së shtetasve që nuk u lejohet udhëtimi drejt zonës "Shengen". thuhet ndër të tjera në njoftimin e policisë për arrestimin e kontrollëve.



MIRA RAKACOLLI

**"DENOJME DHUNËN"**  
 "Jemi të gjithë të ndërgjegjshëm për veprimet e dhunshme që kanë ndodhur ditët e fundit ndaj mjekëve, dikush kërkon vaksinë në ambientet e urgjencës dhe familjarët kanë reaguar me dhunë fizike ndaj mjekut dhe nuk i është mohuar shërbimi. Nuk është dhuna zgjidhja. Ne jemi të vendosur dhe krah mjekëve për t'i mbrojtur ata", - tha Rakacolli.



TRITAN SHEHU

**"KUNDËR NËPËRKËMBJES"**  
 "Protesta është kundër situatës tragjike e pa asnjë perspektive të sistemit tonë shëndetësor, pagesave qesharake, kontrollit politik ekstrem mbi atë, kushteve të vështira teknike, kundër nëpërkëmbjes së dinjitetit të mjekëve, infermierëve etj.", - thekson deputeti i PD-së.



BARDH SPAHIA

**"SHKATËRRIMI I SHËNDETËSISË"**  
 "Ministria e Shëndetësisë, pasi i humbi mjekët tenton dëshpërimisht t'u solidarizohet. Nuk ka mjek që mos ta dijë që dhuna ndaj tyre në shumicën dërrmuese të rasteve, është rezultat i shkatërrimit të sistemit shëndetësor", - thotë deputeti i PD-së, Bardh Spahia.

Ministria e Shëndetësisë krah bluzave të bardha, deputetët e PD-së: Tentativë djallëzore

# Mjekët, protestë kombëtare kundër dhunës në krye të detyrës: Qeveria, fajtoare

Mjeku i dhunuar, Stroni: Tolerancë zero ndaj akteve të vandalizmit

Voltiza Duro

Mjekët e Qendrës Spitalore Universtitare "Nënë Tereza" kanë protestuar ditën e djeshme kundër akteve të dhunës ndaj tyre, të shpeshta këto muajt e fundit. Protestës së tyre i janë bashkuar edhe mjekët e spitalit rajonal të Shkodrës dhe të Durrësit, të cilët kanë kërkuar siguri në punë dhe kushte më të mira gjatë kohës që janë në krye të detyrës. Bluzat e bardha gjatë protestës, kanë treguar vështirësitë me të cilat përballen çdo ditë dhe më tej akuzuan qeverinë lidhur me politikat e ndërmarra në shëndetësi. "Vaksinë për problemin tonë nuk ka, por vaksina gjendet. Populli ta ketë të qartë që mjekët nuk ua krijojnë problemet, janë politikat ato që duhet të ndryshojnë. Mos harroni që në 1997 kur tërë shteti u shkërcua ishin mjekët ata që qëndruan gati për të ofruar ndihmë. Nuk i keni nga mjekët problemet, nuk jeni të varfër nga mjekët, e nëse flitet që për ata që shkelin barin në fushën e futbollit të dënohen 3 vjet, ata që dhunojnë mjekët e kanë pak edhe 30 vjet", - tha mjeku i njohur infeksionist, dr. Tritan Kalo.

**DEKLARATA E MJEKËVE**  
 "Mjekësia moderne nuk është as e lirë, e as 100% efektive për kurimin e sëmundjeve në të gjitha rastet. Duhet të jetë e qartë se jo të gjitha rastet e rënda do t'ia dalin me sukses, pavarësisht përpjekjeve të personelit mjekësor, dhe kjo nuk duhet të përkthehet në dhunë e përplasje. Duhet të jetë e qartë se vandalizmi dhe dhuna ndaj personelit mjekësor, në krye të detyrës është një krim penal dhe çdo shoqëri e civilizuar duhet të ketë tolerancë zero ndaj akteve të tilla", -tha mjeku infeksionist Arian Harxhi në fjalën e tij. Ky i fundit shtoi se të gjithë personat politikbërës, opinionbërës dhe mediatikë duhet t'i dënojnë aktet e dhunës, pasi kjo e fundit sipas Harxhit çon në ulje të cilësisë nga ana e bluzave të bardha. "Kjo është një thirrje për veprim, për bashkim. Së



bashku duke folur në një zë, ne duhet t'i themi stop dhunës ndaj personelit mjekësor. Është një thirrje për të gjithë instancat përkatese që të bashkohen me kauzën tonë. Ka ardhur koha që të rishikohet kuadri ligjor përkates në mënyrë që dhuna dhe agresioni ndaj personelit mjekësor në kushtet e punës, të konsiderohet si formë e rëndë e cenimit të personit dhe të marrë dënimin maksimal", -tha mjeku infeksionist në deklaratën e tij për mediat.

**RISHIKIM LIGJIT**  
 "Ka ardhur koha që të rishikohet kuadri ligjor përkates në mënyrë që dhuna dhe agresioni ndaj personelit mjekësor në kushtet e punës, të konsiderohet si formë e rëndë e cenimit të personit dhe të marrë dënimin maksimal", - tha mjeku infeksionist në deklaratën e tij për mediat.

të bardhë"-tha mjeku infeksionist, Gentian Stroni, i dhunuar disa ditë më parë në krye të detyrës. Mjekët në Shkodër i bënë thirrje politikës që të dëgjojë zërin e bluzave të bardha dhe të marrë masa parandaluese

ndaj akteve të dhunës. "Personeli shëndetësor kërkon ambient punë të sigurt, të lirë, larg bulizmit dhe provokimeve. Ne jemi të kujdesur për pacientët tanë, por dhuna nuk sjell cilësi në shërbim. Dhuna lodh e ndikon tek kujdesi që ne duhet të ushtrojmë. Nëse mjekët e infermierët nuk janë të sigurt edhe pacientët nuk janë të sigurt. Dhuna duhet parandaluar para se të ndodhë, ndryshimi duhet të nisë nga ne. Kjo është një thirrje për veprim, për bashkim. Të flasim nën një zë, politika të dëgjojë", - tha një mjek në Shkodër.

**REGAIMET**  
 Në mbështetje të mjekëve ishte edhe zv.ministria e Shëndetësisë, Mira Rakacolli, e cila tha se do të jenë në krah të bluzave të bardha. "Jemi të gjithë të ndërgjegjshëm për veprimet e dhunshme që kanë ndodhur ditët e fundit ndaj mjekëve, dikush kërkon vaksinë në ambientet e urgjencës dhe familjarët kanë reaguar me dhunë fizike ndaj mjekut dhe nuk i

**KERKESAT**  
 Gjatë protestës së djeshme, mjekët kanë thënë që së shpejti do të dalin sërish, por me një platformë të qartë me kërkesa drejtuar qeverisë. "Ne do të dalim me disa kërkesa që kanë të bëjnë pikërisht me mbrojtjen tonë dhe shmangien e dhunës, siç është për shembull vendosja e një mbrojtjeje policore apo dhe shkallëzimi i ligjshmërisë për të bërë të mundur dënimin maksimal të atij që kanos një mjek ose një bluzë të bardhë", - tha mjeku infeksionist, Gentian Stroni, i dhunuar disa ditë më parë në krye të detyrës.

**DR.MIRA RAKACOLLI**  
 Në mbështetje të mjekëve ishte edhe zv.ministria e Shëndetësisë, Mira Rakacolli, e cila tha se do të jenë në krah të bluzave të bardha. "Jemi të gjithë të ndërgjegjshëm për veprimet e dhunshme që kanë ndodhur ditët e fundit ndaj mjekëve, dikush kërkon vaksinë në ambientet e urgjencës dhe familjarët kanë reaguar me dhunë fizike ndaj mjekut dhe nuk i është mohuar shërbimi, apo rasti tjetër që është referuar në një spital tjetër. Nuk është dhuna zgjidhja. Ne jemi të vendosur dhe krah mjekëve për t'i mbrojtur ata", - tha zv. ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Dr. Mira Rakacolli.

është mohuar shërbimi, apo rasti tjetër që është referuar në një spital tjetër. Nuk është dhuna zgjidhja. Ne jemi të vendosur dhe krah mjekëve për t'i mbrojtur ata", -tha zv.ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Dr. Mira Rakacolli. Ndërkohë, kryeministri kërkoi dy ditë më parë, dënim me tre vjet heqje lirie për ata që hyjnë në fushën e blertë, ndërsa për dhunuesit e mjekëve duhet dënim 10 herë më i lartë pohan ata. Mjekët kërkojnë plotësimin e një sërë kushtesh që nisin me infrastrukturën në spitale, po ashtu edhe paga të justifikojnë profesionin e tyre. Edhe pacientët kanë qenë në krah të mjekëve dhe kanë thënë se

dhuna ndaj bluzave të bardha në spitale është e patolerueshme. Ndërkohë deputeti i PD-së, Bardh Spahia e cilësoi si djallëzore mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë ndaj mjekëve. "Ministria e Shëndetësisë, pasi i humbi mjekët tenton dëshpërimisht t'u solidarizohet". Skandaloze dhe tejet djallëzore tentativa e Ministrisë së Shëndetësisë për ta hequr fajin nga vetja. Nuk ka mjek që mos ta dijë që dhuna ndaj tyre në shumicën dërrmuese të rasteve, është rezultat i shkatërrimit të sistemit shëndetësor; i mungesave dhe mangësisë të tmerrshme në ilaçe, pajisje e materiale mjekësore, por edhe korrupsion ekstrem dhe paafitshmëri menaxheriale", thotë deputeti i PD-së, Bardh Spahia.

Publikohet në Fletoren Zyrtare lista me personat që u është njohur e drejta për kompensim

# Dosjet 1993-2013, lista me 611 pronarët që marrin paratë

## Përfituesit në të gjithë vendin, ja si do të paguhen

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën e 611 me pronarët që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilën dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosje të cilave Agjencia e Trajtimit të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohë në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të dosjeve dhe pronarët që nuk janë njohur me vendimin duhet t'i drejtohen gjykatës.

**KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK**  
Sipas formularëve-tip, mësohet se kërkuesi duhet të

cilësojë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës, vërtetim nga gjykata nëse vendimi përfundimtar i vlerësimit të tij është ankimuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndry-

shuar rrethi i trashëgimtarëve, prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numër llogarie, vërtetim nëse subjekti ka përfutuar ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

### LLOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të

kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuar financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompen-

sohet fizikisht, nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave thotë se subjektet e shpronësuar u nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

### LISTA ME 611 PRONARËT QË MARRIN PARATË

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Durrës	Hysen Kasa	4400	830
Korçë	Bexhet Çollaku		514
Korçë	Pellumb Hysolli		1200
Tiranë	KAMBER DALTI (DAJA)	5295	5273
Tiranë	ZEF BORIÇI	116.5	756
Tiranë	Isa Lezha	150	20
Gjirokastër	Adem DHRONI		780
Korçë	George XHENNAR KENO, XHENNAR KALLA	293	625
Korçë	Alië Koçiu	245	1230
Korçë	KUJTIM QERIMI		1212
Korçë	Barjam Kroj (Tresova)	784	1056
Korçë	Baki Shehu	682	868
Vlorë	Hasan, Krenar Cekodhima		7000
Korçë	Hekuran Shehu		440
Korçë	Stefanaq Projko		2590
Vlorë	Axhem Haxhiraj	5000	5335
Vlorë	Razi Dervishi		5000
Korçë	Medime Spaho		491
Korçë			40.2
Korçë		40.2	0
Tiranë	MYHYRIJE XHERHANI		0
Durrës	Abaz Kupi, Hava Kupi		660
Berat	Çelnik Lamçe	3400	7570
Gjirokastër	Hajri Hodo		600
Korçë	Seit Shahini	2836	2778
Korçë	Luze Shahini	5297	2858
Shkodër	Rustem Kadria		1539
Shkodër	Mara Tome Guga		3773
Tiranë	HAMDI GRECA		24100
Tiranë	SHYQYRIE TOPTANI	675	1057
Tiranë	FRASHERI		12770
Tiranë	Faik Tomini	10000	60000
Berat	Çelnik Lamçe	3400	7570
Berat	Maliq Lamçe	3000	4300
Berat	Çelnik Lamçe	3400	7570
Gjirokastër	Andrea Telo	1828	600
Korçë	Muharem Besim Bejleri	186	314
Korçë	Hysni Sejdo	990	20
Korçë	Vaskë Kolaci	1046	8555
Kukës	Sami Ahmet Ferizi		300
Durrës	Mustafa (Mujo) Gjokolli	5000	22000

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Durrës	Abdyl Berhami		160
Korçë	Nazime Sali Liço	2155	0
Tiranë	SHPETIM GEGA	583.25	464.56
Korçë	Ylfete Rusi	130	30
Durrës	Ali Korriku		48
Durrës	Medi Riza Arifi		2140
Fier		800	0
Korçë	File Simeoni		433
Tiranë	Xhavit Mema	61	68
Gjirokastër	Qemal Muka		1875
Gjirokastër	Ramo Meto Guçe		3400
Korçë	Zarif Jagolli		750
Korçë	Nuri Mustafa	600	1031
Korçë	Nuri Mustafa		1500
Korçë	Ymer Cizi	1420	3873
Korçë	Vangjel Stasa	155	568.7
Tiranë	MEHMET CEKA		169.2
Durrës	Murat Abazi	549	951
Korçë		5022	2751
Kukës	Mal Ibrahim Lala		9938
Kukës	Sherif Cakrraj	2050	0
Tiranë		2593	2426
Durrës	Rudolf Koka		89000
Gjirokastër	Caush Sinani		1400
Korçë	Fatiko Revani	2776	583
Korçë	Edison Xhaho	1889	556
Korçë	Hekuran, Emine Çarçani		748
Korçë	Sefedin Repa	2360	2640
Korçë	Fatime Galo	796	178.5
Elbasan			15200
Elbasan	SHEFQET MIRAKA		6890
Elbasan			1300
Elbasan	Rrahman Doda	135	431
Fier	Hiqmet Hebeja		7140
Gjirokastër	Lyto Hysa	60	368.5
Korçë		980	1982
Kukës	Mehmet Ismail Laçi	2109	19000
Tiranë	ISMAIL ALIBALI	2455	724
Vlorë	Kamber Dino	390	259
Vlorë	Thoma Caci	170	257
Vlorë	Kujtim Hoxha		225

Vlorë	Kozma Mone		775
Vlorë	Fatbardha Hallko		3000
Vlorë	Luftar Beqo	1988	10000
Vlorë	Bani Aliaj		890
Fier	Bilbil Siqeca	8400	2250
Vlorë	Qerim Gurabardhi	550	4450
Fier	Llambriini Shkurti	7837	1260
Gjirokastër	Refat Kasimati	471	85
Korçë	AVNI HOXHA	400	2750
Shkodër	Ded Luk Dushkja		500
Korçë	Namik Spaho		1354
Korçë	Sali Hysen Gega	848	406.3
Korçë	Gelajdin Ajçe	5568	608
Korçë	Teqi, Hatixhe, Mynyre Bylyku	1450	250
Korçë	Florent Ademi		5630
Korçë	Beqir Tacelli		200
Korçë	Sitki Mullaj		460
Korçë		310	1094
Tiranë	SEJRIFE KASHAMI	3997	2000
Korçë	Dhoksi Gaçi		1437
Elbasan	PETRIT SALIU	4740	2240
Korçë			911
Tiranë	FADIL ELEZI		1908
Tiranë	EMINE GERDARI		2250
Tiranë	MURAT CARA	4517	2330
Korçë	Ajdin Sabedin Çaçi	1348	2614
Korçë	Elife Kapo, Salo Kapo		900
Korçë	Besim Caco	440	1803
Korçë	Vasillo Kotorri		55
Korçë	Mihal Duro	200	3203
Dibër	ALI BEXHET DACI	672	730
Vlorë	Bajram Hanaj	1340	3015
Korçë	Ali Merolli	170	830
Kukës	Zarife Arif Tobli		8392
Kukës	Elmaz Qemal Dokle	588	38931
Kukës	Pellumb Maliq Shehu	2825	1049
Tiranë	ENRIK COBA		0
Korçë	Seit Taho		3000
Korçë	Xhafer Kapo	871	1260
Korçë	Petrit Isaku		3496
Korçë	Muhamet Ceno, Xhafer Ceno	1007	250
Korçë	Fatmir Alishaj	1410	1262
Korçë	Dylberie Meçe, Nesibe Meçe	1344	268
Korçë	Vait Tafo		1920
Durrës	Panajota Hoxha	3915.25	0
Gjirokastër	Tefta Bano	302	294
Tiranë	MEHMET HYSEN GJUZI	14657	500
Tiranë	LUAN KETA	187	700
Tiranë	EQEREM VATHI	2750	2610
Tiranë	FEJZI DOMNI	261	45
Gjirokastër	Isa Hodo		4716
Tiranë	ELENI, SOTIR, DIJANA, IKMA SUEFINI		258
Tiranë		10000	157070
Gjirokastër	Robert Vaso	1185	315
Durrës	Avdyll Keçi		5000
Kukës	Tahir Uke Gjyriqi	5000	14962
Shkodër	Zef Ndreka		4000
Durrës	Josif Çerma		179
Durrës	Sabri Vaja	2388	552
Fier	Besim Hatija, Bexhet Hatija		10800
Lezhë	Fran Loshi	7045	5355
Tiranë	ANILA KELLICI	77	273
Shkodër	Luigj Kole Pepaj	6138	4000
Tiranë	HYSNI REKA		108
Fier	Hysnie Hajdari		8000
Fier	JOVAN RRUDHA	4000	15200
Fier	QAMIL NESHA		10136
Korçë	Bashkim Shehu	1072.2	297.5

Korçë	Xhemal Collaku, Zini Collaku	550	621
Korçë	SHABAN HOXHA	1882	2118
Tiranë	ZENEPE KERCUKU		48
Tiranë		260	242
Tiranë	MIKAIL BOZHIQI		306
Korçë	Shkendije Mullaj	258	277
Kukës	Niman Mula		0
Korçë	Ollga Pema	252	150
Korçë	Piro Tasellari	3	56.5
Kukës	Naim Selman Lashi	1031	1250
Tiranë	FIQIRI SHERRI	435	724
Korçë	Idajet Zotolli	281	715
Berat	Qemal Duro	1000	1000
Elbasan	Ismail Musta		2200
Elbasan	Mahmut Sina		924
Elbasan	Hazis Duka		2000
Fier	Dalip Krakulli	6590	8382
Fier	Haki Bejko	102	4448
Fier	Evgeni Bano	120	28
Korçë	Fana Papa		405
Korçë		3069	250
Korçë	Athina Pallamari		405
Korçë	Domka Qam Kendezi, Nevruz Qam Kendezi		780
Korçë	Filip Koki	123.5	279.63
Korçë	Ollga Sendu	123.5	279.63
Tiranë	MUST AFA LIKA	4160	2982
Tiranë			0
Tiranë	ROZA NDOC DEDA	417	528
Tiranë	EDMOND SEMINI	400	184
Tiranë	Jorgji Panteqi		431
Dibër	Dude Llubani	468	532
Korçë	Gani Bega		1606
Gjirokastër	Parim Dosti		4395
Tiranë		2148	692
Elbasan	HAJDAR QOSIA	60	10125
Tiranë	SHPETIM FAGU	10440	50406.75
Elbasan	Kujtim Hysa		7010
Korçë	Muhamet Kambo	700	370
Korçë	Kristaq Palo	300	3642
Fier	Hiqmet Saliaj		4087
Fier	Vangjeli Stroni	180	552
Tiranë	HYSEN E GEZIM PETRELA	18503	872
Vlorë	Zaira Hamzaraj	6500	3500
Elbasan	SHKELQIM NONAJ		0
Gjirokastër	Doro Kopo		2800
Gjirokastër	Rushit Dosti		6000
Gjirokastër	Sefedin Kapollari		4000
Gjirokastër	Dhimiter Proko	630	300
Korçë	Shaban Ademi		6625
Korçë	Euklid Shomo	1183	953.3
Durrës			2457
Tiranë	ISUF BESHIRI	13202	135043
Elbasan	Tomorr Zani		1155
Elbasan	NAZMI KOTORRI	5070	10613
Korçë	Neki Spaho		389
Korçë	Zija Gegolli		150
Tiranë	HAKI MAHMUDI		741
Tiranë	BUJAR LLAGAMI	113	537
Tiranë	BUJAR LLAGAMI	208	442
Fier	Vangjel Bendo	600	4275
Fier	jashar myftari		1500
Gjirokastër	Çerçiz Ligu	1520	160
Korçë	Hysen Qerim	885	415
Korçë	Drita Shefki Maksuti	347	158
Korçë	Mukades Shurdho, Shefiqe Shurdho	3464	289.5
Korçë	Satber Demiraj		944
Lezhë	Zef Mark Laska		16177

# VIP

Suplement  
Pages

E mërkurë 13 Mars 2019

GAZETA SHQIPTARE

Redaktore: Pamela Aliaj


## "BULEVARDI POLITIK"

- Grida Duma, motoristja më interesante në kryeqytet
- Lefter Maliqi zyrtarisht deputet, ndarje prekëse me stafin e burgjeve
- Namik Dokle kthehet nostalgjik në Kuvend, pritët nga ish-kolegët
- Një grua fut në telashe ministrin italian

Së shpejti kënga hit? Rita Ora flet për herë të parë për bashkëpunimin me shqiptarët



Nik Xhelilaj rrëfen peripecitë në Turqi: Më refuzuan vizën



Ndarjet e të famshmëve dhe lidhjet e reja brenda një kohe të shkurtër



**Kur dyshi është numër i fatit,  
VIP-at shqiptarë që s'patën  
fat në martesën e parë**

*Nga Aurela Hoxha te Rovena Dilo, njerëzit e njohur që gjetën 'fatin' në zgjedhjen e dytë*

Ndarjet e të famshmëve dhe lidhjet e reja brenda një kohe të shkurtër

# Kur dyshi është numër i fatit, VIP-at shqiptarë që s'patën fat në martesën e parë

Nga Aurela Hoxha te Rovena Dilo, njerëzit e njohur që gjetën 'fatin' në zgjedhjen e dytë

Pamela Aliaj

Është e vështirë që të gjelesh dashurinë e vërtetë dhe që më vonë të përfundojë për fat të keq për çfarëdo arsye në ndarje. Për shumë veta tashmë kjo lloj ndjenje është kthyer në mit dhe të shumtë e kanë braktisur tempullin e martesës për të zgjedhur në shansin e dytë me partnerin tjetër thjesht bashkëjetesën. Një rast të tillë e shfaqin shumë mirë dhe VIP-at shqiptarë, të cilët nuk patën sukses në martesën e parë dhe në të dytën ata kanë zgjedhur sërish martesën apo dhe bashkëjetesën. Ndërkohë që disa prej tyre të cilët patën vërtet fat me 'numrin dy'!

## TEUTA KRASNIQI- BLERO MUHARREMI

Disa vite më parë lajmi së Blero dhe Teuta po ndahen pushtoi mediat. Këngëtarja dhe aktorja shumë herë mohuan se martesë e tyre ka marrë fund. Por meqenëse këto nuk ishin vetëm spekulime, ish-çifti u "dorëzua" dhe e pranuan publikisht se ata tashmë ishin ndarë. Teuta dhe Blero ishin bashkë që nga viti 2009 dhe janë prindër të një fëmije, vajzës Tarës. Tani që të dy kanë krijuar jetë të re, por vazhdojnë të jenë prindër të përkushtuar. Teuta tashmë është martuar me Adionisën me të cilin ka dhe një vajzë, ndërkaq Blero do të martohet shumë shpejt me modelen Afrona Duka.

## INVA MULAJ-PIRRO ÇAKO

Tashmë kanë kaluar disa vite nga divorci i famshëm i çiftit Inva Mulaj dhe Pirro Çako. Ata nga kjo martesë kanë djalin Anthony Çako, i cili pas ndarjes së prindërve vendosi të jetonte në Francë me nënën e tij, duke qenë se aty kishte shkollën dhe miqtë. Sopranoja shqiptare është martuar përsëri me biznesmenin e pasur shqiptar Ethem Ramadani ku edhe nga kjo martesë ka një vajzë. Muajve të fundit është folur rreth një ndarje të mundshme të çiftit por që asgjë nuk është vërtetuar, ndërkaq Pirro mbetet 'romantiku i përjetshëm' pranë të cilit ende nuk është konfirmuar një femër.


## ALUNA SEJDIU- RILIND REKA

Këngëtarja shkupjane dhe Rilindi, djali i ish-ambasadorit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian, ndanë rrugët në vitin 2011. Arsyet ishin nga me të ndryshmet. Tuna më vonë krijoi një lidhje të re dashurie me reperin e njohur Cozman, por edhe kjo lidhje nuk eci. Ndërkaq këngëtarja Tuna është martuar me bateristit Patris Berisha me të cilin ka dhe një djalë të quajtur Tian.


## EDONA LLALLOSHI - GAZMENDI



Aurela Hoxha dhe Admir Ismajlukaj



Soni Malaj dhe Mirko



Teuta Krasniqi dhe Blero Muaharremi

Disa vite më parë u martua edhe këngëtarja Edona Llalloshi, por nuk i eci martesë, ajo kur pati deklaruar se u nda nga bashkëshorti, tha se është munduar ta mbajë martesën, por fati i saj ishte që të ndahen. Ajo tashmë është e martuar me një tjetër burrë, Gazin, dhe ka dy fëmijë.

Soni Malaj-Mirko Lucarelli Dy të rinjtë u njohën dhe u dashuruan në spektaklin e vallëzimit "Dancing with the stars". Ata kurorëzuan dashurinë e tyre duke u martuar. Më pas pas 4 vjetësh, martesë e këngëtares Soni Malaj me balerinin italian Mirko Lucarelli merr fund. Ata janë prindër të një vajze Anna, dhe pas ndarjes e tërë dashuria e tyre shkon për Annën e vogël. Tashmë Soni është në një lidhje katër vjeçare me Klevin ku kanë nisur dhe bashkëjetesën.

## ERLETA HOTI- KASTRO ZIZO

Kanë kaluar më shumë se 3 vjet

që nga ndarja e Kastros me vajzën e njohur të ekranit kosovar Erletën. Ata ishin martuar në vitin 2012 në një ceremoni private dhe jetonin të dy në Prishtinë. Nia është vajza e tyre nga kjo martesë. Kujtojmë se Erleta ka qenë gruaja e dytë e Kastro Zizos ndërkaq këngëtarja i njohur ka qenë martuar më parë me Jola Parapanin me të cilën ka dhe një djalë të quajtur Dankan. Për momentin Kastro, si tip i paqëndrueshëm në lidhjet e tij nuk është një marrëdhënie edhe pse para një viti spekuloi për një martesë të tretë, por që rezultoi një trill i këngëtarit.

## SABRI FEJZULLAHU:

Edhe Sabri Fejzullahu, babai i Ermal Fejzullahut, ishte i martuar me dike tjetër para Nerës. Arsyet e ndarjes këngëtarit thotë se kanë qenë jo për shkak të ndonjë moskuptimi apo xhelozie, por për shkak se këndvështrimi i tyre për artin ishte i ndryshëm. Tashmë

këngëtarja është prej shumë vitesh e martuar me Nerën dhe është baba dhe gjysh i lumtur.

## AURELA HOXHA- ADMIR ISMAJLUKAJ

Në fillim, Aurela Hoxha fliste për një marrëdhënie të pastër, mes dy të rinjsh që u njohën në shkollën e pallatit. Ajo e sapo ardhur në Tiranë dhe ai po ashtu nga Tropoja, rastisën komshi dhe nisën dashurinë e tyre gati 13 vjeçare. Prej 10 vitesh të martuar, në fund të verës, ish-bashkëshorti i modeles iu drejtua gjykatës me pretendimin se Aurela nuk përbush detyrimet familjare. Modelja duket se nuk e vuri ujën në zjarr edhe pse thashethemet që u përmendën në shkrimet e ndarjes, e sulmuan si tradhtarë. Këtë pjesë, ajo deshi ta mbajë private, ndërsa për publikun si për t'u shfaqësuar, u kujdes t'i dhurojë foto seksi në rrjetet sociale. Ndërkaq 'Gazeta Shqiptare', zbuloi vetëm një ditë më parë se ajo ka nisur romancën

dy-vjeçare me Albanin nga Miloti ku dhe bashkëjetojnë në Spanjë.

## ROVENA DILO- FLORIAN RIZA

Rovena Dilo prej kohësh nuk po kalonte kohë të mira në jetën e saj. Pas problemeve që pati në verë mbi pronësinë e lokalit, "fati i keq" sërish nuk iu nda. Partneri i saj Florian Riza iu drejtua gjykatës, ku kërkoi divorcin pas 10 vitesh marrëdhënie me Rovënën. Ish-futbollisti i njohur pretendoi në kërkesë-padi se martesë e tyre kishte humbur kuptimin dhe ishte kthyer thjesht në dëctë formale. Përkundër publikimit të faktimit në media, Rovena Dilo nuk bëri asnjë përpjekje të qartësojë arsyet e ndarjes me partnerin, por këngëtarja u hodh në krah të një tjetri, kësaj here për të vallëzuar në skenë. Me pjesën artistike, po njësoj si koleget e saj, Rovena Dilo u mundua ta anashkalojë situatën jo të mirë në të cilën publikisht, u gjend papritur. Ndërkaq tashmë këngëtarja përfillet se është në një romancë disa-vjeçare me balerinin dhe njëkohësisht edhe partnerin e saj në "Dance with the stars", Eltton Merja ku përfillet se kanë nisur prej vitesh edhe bashkëjetesën.

## FLORIANA-TEDI NGJELA

Ndarja e moderatores së "Jo vetëm modë", Floriana Garo bëri shumë bujë edhe pse asnjëherë nuk u arrit të zbulohet shkak i saj. Durrakja 28-vjeçare nisi historinë e dashurisë me ish-partnerin në Amerikë, braktisi jetën atje për t'u rikthyer në Shqipëri. Ashtu si koleget, as Floriana nuk deshi të shprehet për arsyet që e çuan në ndarjen me të fejuarin, milionerin Tedi Ngjela. Edhe pse mediat shkruan se marrëdhënia e tyre kishte kohë që ishte ftohur, për shkak të udhëtimeve të shpeshta dhe karrierës së moderatores, ajo nuk i dha asnjë shpjegim fansave, të cilëve nuk kishte lënë gjë pa i rrëfyer nga raportit me Tedin. Tashmë prej dy vitesh Floriana jeton në Vjenë të Zvicrës e martuar me biznesmenin dhe avokatin Enis Daci me të cilin ka dhe një vajzë, Adian.



Edona Llalloshi dhe Gazmendi



Rovena Dilo dhe Florian Riza



Floriana Garo dhe Tedi Ngjela

Martesa e këngëtares së njohur, Adelina Tahiri me milionerin maqedonas bëri shumë përshtypje dhe ngriti shumë diskutime tek ndjekësit e saj. Përpos faktit që është më i vjetër në moshë, partneri i Adelina Tahirit, Serjoza Markov është përfolur edhe për martesën e parë, nga e cila ka një vajzë. Në profilin zyrtar të vogëlushit Jon në 'Instagram', që e menaxhon vetë Adelina, së fundi është publikuar një foto e motrës së Jonit. Jana Markova është vajza e bashkëshortit të Adelines, e cila me sa duket paska marrëdhënie të mira me familjen e re të të atit. Ajo ka pozuar duke mbajtur në krahë të voglin Jon, i cili duket mjaft fotozhenik për kamerën. Para martesës më këngëtares shqiptare, Serjoza ka qenë edhe më parë i martuar. Në një intervistë kohë më parë, Adelina ka treguar për raportet e mira që ka me vajzën 20-vjeçare të bashkëshortit.



**Nuk e prisnim! Adelina Tahiri prezanton vajzën e bashkëshortit nga martesja e parë**

Pasi së fundmi nuk e ndiqnin më njëri-tjetrin në 'Instagram', Lori Hoxha dhe Vis Bajraktari janë kthyer në çiftin më të përfolur të kohës. Ndërkaq që jo më larg se dje, në media u përhap lajmi se dyshja i ka dhënë fund lidhjes disavjeçare. Prej kohësh ata nuk kanë bërë asnjë publikim se ndodhen bashkë e megjithatë kjo nuk i rriti dyshimet tona deri në momentin kur hymë në profilin e Visit, për të parë se aty mungonte fotoja e tij e fundit me Lorin. E kemi fjalën për foton e realizuar në avion ku Lori ishte ulur në prehrin e partnerit të saj. Kjo foto mungon sot në profilin e Vis Bajraktarit dhe kjo na bëri që të dyshojmë se marrëdhënia e tyre mund të mos jetë si më parë. Dje "Newsbomb" raportonte se çifti jo vetëm që është ndarë, por Lori ka nisur një lidhje të re. Nuk e dimë sesa e vërtetë është kjo, pasi asnjë nga palët nuk e ka konfirmuar. Pak më parë Lori ka bërë një postim në lidhje me një bisedë imagjinare mes ankthit dhe vetes, dhe nuk e dimë nëse vërtet ndihet kështu këto kohë. Ndërsa Visi së fundi ka qenë në një udhëtim me shokët në Vjenë, nga ku ka realizuar edhe një foto ku i ka komentuar motra e Lorit, Redia: "Hajde Hajde", shkruan ajo ndërkohë që ai ia kthen "Më prit!". Ende duket e pazgjidhur situata mes tyre.



**U ndanë përfundimisht? Detaje të reja rreth 'krizës' në marrëdhënien Lori-Visi**

Nik Xhelilaj prej kohësh tashmë është bërë pjesë e kinematografisë ndërkombëtare dhe së fundmi, asaj turke. Aktualisht ai po zhvillon xhirimet për një serial turk, ku do të luajë rolin e një personazhi shqiptar me origjinë nga Prizreni. Rreth një vit më parë ai ka rrëfyer për "RTV 21" se tematika e filmit ka të bëjë me Sirinë: "Do e nis me rolin e terroristit, por në serialet turke nuk dihet se si përfundon." Ka qenë Orinda Huta e cila në promon e puntatës së radhës të emisionit "Jo vetëm modë", ka bërë publike disa sekuenca të shkëputura nga intervista e realizuar, që pritet të transmetohet këtë të shtunë. Aktori ndër të tjera dëgjohej të shprehet kështu:



"Shansi im që në Shqipëri në ato vite pati një erë të mirë në qendrin e kinematografisë shqiptare. Pas katër vitesh për të marrë përgjigjen, refuzim vize!" Mirëpo sipas tij, regjisori turk e kishte ndarë mendjen dhe i ka zhvilluar audicionet në Tiranë. Po ashtu ai pohoi se personazhi i tij në film ka të bëjë me vrasje dhe eliminime personash të ndryshëm. I pyetur për raportet e tij me femrat, Niku është shprehur duke qeshur se i ka të mira: "Në raportet e mia private me femrat i mirë jam. Vetën për të mirë e di."

**Nik Xhelilaj rrëfen peripecitë në Turqi: Më refuzuan vizën**



Në fund të janarit, këngëtarja me famë botërore, Bebe Rexha, i bëri një ftesë tre këngëtareve të njohura shqiptare në Britaninë e Madhe për të bashkëpunuar. Dhe ky propozim na u duk ajo që do të përbente këngën më të përfolur dhe më hit të kohës. Por që pas atij statusi askush nuk foli për të, deri më tani. Në një intervistë për radion filipinase "MYX", Rita Ora u shpreh rreth këtij bashkëpunimi me artistet shqiptare, Bebe Rexhën, Dua Lipën dhe Ava Max. "Nuk kemi filluar ende me bashkëpunimin, por mendoj se do të ishte super fantastike, sepse jemi të gjitha shqiptare dhe ky do të ishte moment magjik për Shqipërinë", ka thënë Rita. Gjithashtu, gjatë intervistës ajo foli edhe për Bebe Rexhën, me të cilën është shumë shoqe: "Ajo është shqiptare si unë, kështu që kam pak kohë që e njoh dhe mendoj se është e talentuar si tekstshkruese dhe artiste". Shpresojmë të realizohet sa më herët!

**Së shpejti kënga hit? Rita Ora flet për herë të parë për bashkëpunimin me Beben, Duan dhe Ava Max!**

# BULEVARDI

## POLITIK

Na merrni seriozisht!

### Grida Duma, motoristja më interesante në kryeqytet!

Ish-deputetja e Partisë Demokratike Grida Duma ka treguar një anë tjetër të sajën që askush nuk e ka ditur më parë. E ftuar së fundmi në emisionin 'Xing me Ermalin', Duma është shfaqur në një tjetër formë. Veshur si motoriste, jashtë profilin politik dhe veshjeve zyrtare, ish-deputetja ka shpërndarë pica nëpër kryeqytet për të gjithë klientët e interesuar. Ajo ka tërhequr vëmendjen e shumë kalimtarëve, të cilët e kanë fotografuar dhe i kanë shpërndarë pamjet në rrjetet sociale duke i bërë kështu virale. Padyshim Grida Duma është motoristja më interesante që keni parë në rrugët e kryeqytetit.



### Lefter Maliqi zyrtarisht deputet, ndarje prekëse me stafin e burgjeve

Lefter Maliqi është një nga prurjet e reja që solli në Kuvend akti i Lopozitës për të djegur mandatet e deputetëve të saj. Deri më tani ai ka mbajtur postin e nëndrejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve në administratën socialiste, ndonëse prej ditës së sotme do të ulet në karriget e deputetëve opozitar. E për të respektuar bashkëpunëtorët e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Maliqi ka qenë dje për herë të fundit në zyrë, ndërsa ka shkrepur edhe disa foto si kujtim për muajt që kaloi në këtë institucion. "Zyrtarisht deputet. Kujtime, mbresa, krenari që punova për 14 muaj Zv.Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve. Ndarje për mos t'u larguar me stafet drejtuese të administratës së burgjeve. Do jem edhe zëri juaj në parlament dhe komisione për të drejtat tuaja ashtu siç do jem zë i fortë për elektoratin dhe interesat e vendit. Kënaqësi që punova me ju. Mirënjohje", shkruan Maliqi në statusin e vet.



### Një grua fut në telashe ministrin italian

Një grua tha se është tallur në internet nga zëvendëskryeministri dhe ministri i Brendshëm italian Mateo Salvini. Ajo ka ngritur akuza ndaj tij, duke thënë se ministri i Brendshëm provokoi një përplasje mesazhesh dhe ka lëshuar "kërcënime të ndyra" ndaj saj. Giulia Viola Pacilli, 22 vjeçe, u fotografua gjatë një marshimi kundër racizmit në Milano më 2 mars duke mbajtur një tabelë që lexonte "Më mirë të jesh një burrë dhe një e përdalë sesa një fashiste dhe salviniste". Në marshim besohet se kanë marrë pjesë më shumë se 250 mijë njerëz. Dy ditë më vonë fotografia u nda nga Salvini, i cili drejton Lidhjen e Ekstremit të djathtë, në faqen e tij në "Facebook" së bashku me mesazhin sarkastik "Ç'grua e bukur", shkruan Guardian. Studentja u bë objekt talljeje online, duke u vënë në lojë, me shprehje të tilla si "nëse donte të kishte të bënte shumë më tepër nga se duhet me emigrantët". Avokati i saj, Giovanni Pintimalli, tha se do të ngrihet padi penale për shpifje ndaj më shumë se 200 vetave që u tallën online me Giulian.



### Namik Dokle kthehet nostalgjik në Kuvend, pritët nga ish-kolegët

Për më shumë se dy dekada, Namik Dokle ka qenë një nga figurat kryesore të socialistëve dhe përfaqësues i përhershëm i tyre në Kuvend. Por prej afro dy vitesh ai ka zgjedhur që të mos angazhohej më si i zgjedhur i popullit në Kuvend, duke iu kushtuar tërësisht krijimtarisë së tij në fushën e letërsisë. Por pavarësisht kësaj duket se Dokle e ka të vështirë të shkëputet totalisht nga ajo që ka bërë për më shumë se gjysmën e jetës së vet, politika. Ai është parë dje në ambientet e Kuvendit ku është pritët me ngrohtësi nga ish-kolegët e tij të partisë dhe grupit parlamentar. Nuk dihet se cila ka qenë arsyeja që ai ishte në Kuvend, por vetëm tri ditë më parë ai kishte ditëlindjen e tij të 73. Siç shihet edhe nga fotot ai është ndjerë i kënaqur për respektin që kanë treguar kolegët, me të cilët ka pozuar edhe për disa foto si kujtim.



## A e kërkon përditshmëria jonë, reportazhin?!

Nga Ben Andoni

Reportazhi është gjinia që e sjell më shumë se cilado tjetër gjini përditshmërinë e jetës sociale. Por, gazetaria jonë jo vetëm e ka braktisur, por e ka zëvendësuar me lajmin bajat apo me fakte të thata pa sfond, që tregojnë vetëm një moment të kaosit që e jetojmë përditë. Në këtë hulli, një grup gazetarësh të mediave lokale dhe të fakulteteve të gazetarisë kanë prodhuar një libret të vogël me disa reportazhe, ku është punuar në grup, por edhe në mënyrë vetanake. Reportazhisti i njohur Fatos Baxhaku dhe kolegja e tij Klodiana Kapo morën përshpër trajnimin e gazetarëve, por edhe prodhimin e këtyre reportazheve, botuar nën titullin "Përtej gardheve". Synimi ka qenë ngjallja e këtij zhanri, pasi fatkeqë-

sisht ai po braktiset dhe redaksitë kanë filluar ta komercializojnë, e këtë jo pak herë. Ato pak reportazhe televizive që duhet të vlerësohen, shpesh u drejtohen fakteve që mund të fryhen, por jo thjesht asaj përditshmërie, që përbën jetesën e shqiptarit të thjeshtë. Ndaj, në kohën optimale në televizion nuk mund të jenë kurrsesi reportazhet e pakta, ku pasqyrohet jetesa e shqiptarit të thjeshtë, por politikë dhe politikë pafund, që të bën të mendosh se jeton gati në një vend krejt virtual. Historitë janë shkruar me thjeshtësi, këndshëm dhe tejet korrekt nga gazetarët, të cilët u trajnuan mbi artin e shkrimit të reportazhit nga kolegët e njohur dhe Institutit për Menaxhim Lindje-Perëndim. Reportazhi si gjini është i lëvruar që gati

para një shekulli në vendin tonë, por forcën e vërtetë e mori në shekullin e shkuar, ku media paqka problematikave, i la një vend të merituar në faqet e veta. Fatos Baxhaku, në këtë vazhde, mendon se: "Konsolidimi i shtetit shqiptar në tri dekadat e para të shekullit të XX solli risi dhe emra të rinj në këtë histori. Gjergj Bubani, Vedat Kokona, Petro Marko ishin më të dalluarit prej tyre që vendosën të komunikonin me lexuesin jo nëpërmjet opinioneve, bërtitjeve politike, apo mendjedhënies. Shkrimet e tyre na tregojnë një Shqipëri sikurse ishte në të vërtetë, që luhatej mes varfërisë së skajshme dhe etjes për t'u dukur një zonjë brilante europiane, mes anadollizmit dhe liberalizmit, mes malarisë dhe luksit, mes shpresës dhe mjerimit". Të

jetë interneti, shkartari i shuarjes së tij?! Këtë nuk mund ta thotë askush, por është një fakt, reportazhi kërkon pak mundime dhe pak financim, që edhe pse janë modeste në krahasim me shpenzimet boshe që bëhen gjithsesi nuk i bindin pronarët dhe shumë drejtues të medias. Duhet të theksojmë se me punën e tyre, të gjithë gazetarët e rinj arritën që të tregojnë se kjo gjini jo thjesht është e domosdoshme, por edhe një gjini që realisht i mungon krejtësisht gazetarisë sonë. Që nga "Motër Maria Kaleta", e realizuar këndshëm nga Shkodra me Emi Kalanë, duke vazhduar me ndër vende të "Gruas së Mirë", realizuar prej Enejda Begës, Kjetlora Gëstentjes, Malvina Tahirit, Arditi Markut; (Devollit) "Njerëzit e fasules" të Lorena Kodrës,



"Prespa e Vogël, liqeni që s'është më" të Dhorjela Demkollit; në Gjirrokastër të "Brumi i jetës" nga Ilirjan Lluri, "Mademet gri të Gjirrokastër", realizuar prej Engjëllit Serjanit; "Ura kryeneçe e Beçishtit" prej Dorina Muhaj; "Labëri, në gjurmë të Kanunit të hershëm", realizuar prej Brikena Metajt; "Të jesh grua në Lunxhëri" prej Kristina Krisafit ke një udhëtim të gjatë që ndërthron historinë e shkuar me përditshmërinë, duke na dhënë një fotografi të bukur dhe të drejtpërdrejtë të Shqipërisë së sotme. Kjo punë e këndshme e materializuar në këtë libret e tregoi se Shqipëria ka nevojë për reportazhin, pasi edhe vetë pasqyrimi nga Shqipëria nuk mund të jetojë dot pa reportazhin.

Flet kreu i ISSH: Më pak sorollatje për të moshuarit, si do kryhet transferimi

# Ndryshon procedura e tërheqjes së pensionit të pleqërisë, ja ku mund ta merrni

Astrit Hado: Lehtësirat që ofrojmë pavarësisht vendbanimit

Voltiza Duro

Pas informatizimit të sistemit të pagesave, të moshuarit në mbarë vendin do të mund të tërheqin pensionin e pleqërisë në çdo arkë të Postës Shqiptare, pa qenë nevoja e transferimit të gjendjes civile. Lajmi është bërë me dije ditën e djeshme nga kreu i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Astrit Hado, i cili thekson se është bërë i mundur lehtësimi i procedurave, pavarësisht vendit ku banon i moshuari. "Tashmë pensionistët mund ta tërheqin pensionin e pleqërisë në çdo arkë paguese të Postës Shqiptare sh.a në çdo qark të vendit, pa pasur nevojë për të transferuar edhe Gjendjen Civile. Si pasojë e përfundimit të procesit të ndërtimit të bazës së të dhënave elektronike dhe unike të pensioneve, informatizimin e sistemit të pagesave dhe të procesit të kontrollit të tyre, është bërë e mundur lehtësimi i procedurave të transferimit të qendrës paguese të pensionit, pavarësisht nga vendbanimi, sipas regjistrimit të gjendjes civile", thotë Hado. Ky i fundit shton se zbatimi i kësaj procedure të thjeshtuar të transferimit të qendrës së pagesës shkurtor ndjeshëm kohën, si dhe vetëngarkon strukturat e ISSH-së për të kryer procedurat e transferimit dhe njoftimin e qytetarit.

**ANALIZA E 2018-ËS**  
Në ambientet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nën drejtimin e ministres, Anila Denaj, njëkohësisht dhe kryetare e Këshillit Administrativ të ISSH, u zhvillua Analiza Vjetore e Institutit të Sigurimeve Sho-



qërore, për vitin 2018. Denaj, ndër të tjera, theksoi punën që duhet bërë në drejtim të mbledhjes së kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, duke vënë theksin në faktin që mbledhja e të dy llojeve të kontributeve duhet të ecë në mënyrë paralele. Drejtori i Përgjithshëm i ISSH, Astrit Hado, gjatë fjalës së tij ka bërë publike disa nga arritjet dhe sfidat me të cilat përballet skema e sigurimeve shoqërore, si një fushë me efekte shumë të gjera sociale, ku preket thuasë çdo familje shqiptare. Ai theksoi se gjatë vitit 2018, për realizimin e misionit të ISSH-së në fushën e sigurimeve

shoqërore dhe në veçanti në fushën e pensioneve, vëmendja kryesore është fokusuar në disa drejtime kryesore si: vazhdimi i punës për implementimin e skemës së reformuar të pensioneve; zbatimi i politikave të qeverisë për rritjen e të ardhurave të pensionistëve, nëpërmjet indeksimit të përfitimeve të caktuara, indeksimit të pagave referuese për përfitimet e reja të vitit e në vazhdim, si dhe nëpërmjet zbatimit të një praktike tashmë të konsoliduar, që është bonusi (shpërblimi) vjetor i pensionistëve. Fusha të tjera ku ISSH ka punuar janë: përmirësimi i ad-

ministrimit të buxhetit të ISSH-së dhe i cilësive së shërbimeve ndaj qytetarëve; vazhdimi i punës për krijimin e një baze të plotë, të informatizuar të të dhënave, siç janë periudhat kontributive të personave, zbatimi i një sistemi të automatizuar të autorizimit dhe pagesave online. "Përmes punës të të gjitha strukturave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore në shkallë vendi, si dhe drejtimet dhe mbështetjes nga Këshilli Administrativ, evidentojmë: realizimin e të gjitha procedurave administrative të indeksimit të pensioneve, si dhe përfitimeve të tjera për mbi 623 mijë për-

fitues, duke filluar nga data 01.07.2018, në masën 2.8%, si dhe kryerjen e pagesave në favor të pensionistëve, me një efekt financiar prej mbi 1,570 milionë lekë.  
Brenda një kohe rekord u kryen të gjitha procedurat administrative të dhënies së shpërblimeve për mbi 650 mijë përfitues, nga sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore, me një efekt financiar prej rreth 3,276 milionë lekë. U zbatuan standarde të reja në drejtim të përmirësimit të shërbimit ndaj pensionistëve, sidomos në fushën e transparencës së përfitimeve të caktuara. Nga 36,796 pen-

sione të reja të caktuara në vitin 2018, 35,031 ose 95.1% janë lidhur brenda afateve ligjore, me një kohë mesatare 24 ditë. Gjatë vitit 2018, i cili përkon edhe me përfundimin e certifikimit të sistemit elektronik të bazës së të dhënave të pensioneve, si dhe të kontrollit të dosjeve të viteve të mëparshme, janë bërë gjithsej 484 kallëzime: 159 çështje janë përfunduar dhe 295 çështje janë në shqyrtim. Përgjithësisht kemi të bëjmë me falsifikim të dokumenteve zyrtare për periudha sigurimi para vitit 1992, të kryera në ndërmarrje problematike, të djegura etj", tha Hado.

**ANALIZA**  
Në ambientet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nën drejtimin e ministres, Anila Denaj, njëkohësisht dhe kryetare e Këshillit Administrativ të ISSH, u zhvillua Analiza Vjetore e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për vitin 2018.

**SHPERBLIMET**  
Brenda një kohe rekord u kryen të gjitha procedurat administrative të dhënies së shpërblimeve për mbi 650 mijë përfitues, nga sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore, me një efekt financiar prej rreth 3,276 milionë lekë. U zbatuan standarde të reja në drejtim të përmirësimit të shërbimit ndaj pensionistëve, sidomos në fushën e transparencës së përfitimeve të caktuara.



### Open Regional Fund Foreign Trade Promotion (ORF FT)

As an international cooperation enterprise for sustainable development with worldwide operations, the federally owned Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH supports the German Government in achieving its development-policy objectives. It provides viable, forward looking solutions for political, economic, ecological and social development in a globalised world. GIZ promotes complex reforms and change processes. Its corporate objective is to improve people's living conditions on a sustainable basis.

#### Background of the project

The Open Regional Fund Foreign Trade Promotion (ORF FT) aims to improve framework conditions for free trade and competitiveness through the promotion of regional cooperation. The ORF FT is implemented through sub-projects with partners from three or more countries from the region. The sub-projects are aimed at eliminating barriers to trade, improving trade procedures on the national level, strengthening institutional capacities for implementing trade-relevant regional agreements (Central European Free Trade Agreement, CEFTA and Stabilization and Association Agreements) and improving services for trading businesses.

Further information on the program can be found at <https://www.giz.de/en/world-wide/20321.html>. The ORF also acquired co-financing from the European Union as of January 01, 2017 for a period of 3 years. The EU-financed component "Support to Facilitation of Trade between CEFTA Parties" forms part of the ORF FT and focuses on 3 areas:

- Component 1: Harmonisation of norms and practices for the elimination of non-tariff barriers in regional trade
- Component 2: Streamlining of document and data submission requirements in regional trade
- Component 3: Simplification of customs clearance procedures; Focus: establishment of a regional Authorized Economic Operators program

The candidate is expected to fulfil tasks within the EU component as well as the BMZ-financed core business of the ORF FT.

#### GIZ Albania seeks the following staff: Office Manager

##### Overall purpose of the post,

The office manager is responsible for:

- providing administrative services for the project
- meeting the administrative needs of the programme independently, with a minimum of input and leadership
- ensuring that financial and administrative regulations are complied with
- depending on candidate qualifications at a later stage the position might be supplemented with responsibilities of junior technical assistant.

##### Main tasks:

#### 1. Secretarial Work and Services

The office manager

- prepares and organizes internal meetings
- supervises adherence to deadlines
- prepares minutes, summaries and lists in agreement with the superior(s)
- coordinates logistical organization of events.

#### 2. Administration

The office manager

- is responsible for organizing administrative and logistical aspects of programme activities (meetings, workshops etc.)
- coordinates with the GIZ office on the mode of service delivery
- ensures that computers and software function properly
- monitors the availability of accessories and stocks and carries out procurement in accordance with guidelines
- is responsible for filing documents in reference files or in DMS in line with GIZ's filing rules
- initiates and supervises local consultancy- and local subsidy contracts as well as financing contracts.

#### 3. Finance and accounting

The office manager

- helps to prepare project budget planning and cost accounting
- helps to monitor costs and spending in accordance with the budget
- is responsible for financial management, such as cash withdrawals, keeping the cashbook, bank accounts
- checks travel expense statements of staff for approval by the superior
- supports the project management to keep track of, to supervise and document the contract provision and to account in agreement with GIZ-standing orders
- supports the programme management in the control of finance reports and files for the cost sheets of the concluded contracts
- checks and delivers the bills to pay and the remaining relevant files in the GIZ-accounting under compliance with internal rules (stamp of the project etc).

#### 4. Other duties/additional tasks

The office manager

- PR focal point
- performs other duties and tasks at the request of management

#### Qualifications and experience sought

Requirements

- University degree in business administration, accounting, finance or related subjects (Master or equivalent);
- At least 3 years professional experience in a comparable position;
- Good working knowledge of ITC technologies (related software, phone, fax, email, the internet) and computer applications (e.g. MS Office);
- Albanian at native level, very good knowledge of the European language widely used in the country; English, preferably in combination with German;
- In-depth understanding of financial planning and reporting and accounting principles;
- Experience of management and administration and in organizing and conducting major events and workshops;
- Willingness to upskill as required by the tasks to be performed – corresponding measures are agreed with management.

#### Contract conditions:

- Part – time employment 50%
- Project office in Tirana
- Assignment period: until 31.12.2019.

Please forward your application until **24th of March 2019**, to GIZ Office Albania by E-Mail: [giz-albanien-hr@giz.de](mailto:giz-albanien-hr@giz.de), including the following information: Application letter, CV in English (Euro Pass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

**GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!**



### PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 9 Mars 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme është si vijon:

Përshkrimi i Produktit	Çmimi prej datës 09.03.2019 (përfshirë TVSh-në)
MARLBORO PREMIUM BLACK KS BOS 20	500 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS LCB 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS BOX 10	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 10	320 Lekë/paketë
MARLBORO FLAVOR PLUS (FWD) KS SRP 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (4 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (6 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.0) 100 RCB 20 XSL	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.5) 100 DSP 20 SSL	280 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS BOX 20	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS RCB 10	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS SLIMSMAG 100 RCB 20 XSL	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC6M KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC4 KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
MERIT BIANCA 100 BOX 20 SSL	220 Lekë/paketë
MERIT (ORANGE) KS RCB 20	230 Lekë/paketë
L&M RED LABEL KS RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 4MG RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 6MG RCB 20	220 Lekë/paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i ndryshuar).

### PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,  
1000 Tirana, Albania  
Tel: +355 42 276 670

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ  
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET  
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR  
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS



KLIPI

# EUROSONG

## Klipi i këngës së Maliqit, elementet e marra nga "Children of the wild"

**K**lipi i këngës "Children of the wild" nga artisti Steve Angelo dhe klipi i këngës së Jonida Maliqit "Ktheju tokës" kanë aq ngjashmëri sa ndokush guxon të përdore edhe termin plagjiaturë.

Vetëm një ditë pasi klipi zyrtar i këngës përfaqësuese të Shqipërisë në Eurosong u bë publik, kanë dalë edhe komentet e para. Po aq sa është pritur mirë, janë vënë në dukje edhe ngjashmëritë mes tij dhe një kënge klipi i së cilës është realizuar pothuaj katër vite më parë. Skena e fëmijës që vrapon në një tokë të rrënuar mes flakëve në mes të natës dhe vetë portretet e dy fëmijëve, djem me flokë të gjatë janë pothuaj njësoj. Përtej idesë së një rrënoje ku vrapohet mes flakëve, klipet asociohen me njëri-tjetrin. Ndonëse është vetëm, një nga pjesët e klipit, reagimet në rrjetet sociale dhe në portale kanë qenë të shumta. Ende nuk ka ndonjë reagim nga produktioni i këngës shqiptare për çështjen në fjalë. E njëjta heshtje ndjehet edhe Radiotelevizioni Publik i cili, ka të drejtën e përzgjedhjes së këngës që përfaqëson shtetin dhe njëherësh financon produksionet që kanë të bëjnë me këngën.

Është e paqartë ende nëse ka penalizime për plagjiaturë në realizimin e klipeve sa i takon Eurosong. Ajo që është e qartë ka të bëjë me faktin se penalizimet vijnë në rastin kur plagjiaturat janë në nota muzikore.

Një vrap për t'i ikur frikës, duke kthyer herë pas herë kokën pas, por duke kërkuar shpëtim. Lexon në hapat që hidhen me nxitim ankthin të ikurve në mesnatë pa parë se ku po i hedhin këmbët. Derisa një shi i madh, duket se lan gjithë baltën që e shkelëm kur ecim në errësirë. Të gjunjëzuar që mezi ngrihen në këmbë, trupa që shquhen po nuk shihen. E kanë lënë fole në si në legjendën e shqiponjës.

"Është kjo foleja e një shqiponje, por që me këtë simbolikë autorët duan ta përgjithësojnë atë me fole në, apo shtëpinë e gjithkujt. Dhe foleja e çdo shqiptari, është Shqipëria. Kur fole në e prishin, e djegin dhe kur gjendesh mes flakësh, t'i mundohesh të gesh shpëtim, e shpëtimi është ikja. Ti ikën, por gjithçka mbetet aty: zanafilla, gjaku, origjina, identiteti e çdo gjë tjetër që të personifikon. Ti ikën, por brenda vetes lufton me dëshirën dhe klithmën e kthimit... Ktheju tokës tënde!", thotë kompozitorja Eriona Rushiti.

Kjo është ideja që përcjell

*Imazhet e ngjashme në fotografi, ku afrohen dy realizimet e viteve 2015 e 2019*



Klipi "Ktheju tokës"

videoklipi i këngës së Jonida Maliqit, "Ktheju tokës", me të cilën përfaqësohet Shqipëria në Eurosong.

Me muzikë dhe tekst të Eriona Rushitit dhe aranzhim muzikor të Enis Mullaj, ky klip vjen i realizuar nga Triangle Studios. Regjisorit Genc Gjineci dhe Andi Kotri e kanë ngritur idenë e klipit mbi simbolin e folesë, sepse mesazhi i këngës vjen i përcjellë nëpërmjet folesë së shqiponjës, ujit dhe zjarrit! Fustani që vesh Maliqi është i stilistit Ardi Asllani dhe ruan të njëjtën ide që ka klipi: tokën, fole në dhe vendin

amë.

Kënga interpretohet në gjuhën shqipe si në klip edhe në skenën e Eurovizionit, në Tel Aviv të Izraelit.

Prej ditës kur u shpall fituese e Festivalit të Këngës në RTSH, vëmendja tashmë është drejtuar nga Maliqi. Këngës i janë bërë edhe covera. Kënga "Ktheju tokës" doli Fituese e Festivalit të 57-t të Këngës në Radio Televizionin Publik Shqiptar dhe konkurren në datë 16 maj në Eurovizion 2019. Në javët në vijim nis nëpër Europë edhe turi promovues i këngës.



"Children of the wild"

## PERSQOP, MONUMENTI IRI I VIZITUESHËM

"Zgjerohet hartën e Tiranës me monumente të reja të vizitueshme duke afruar turistë, studiues dhe brezin e ri përmes programeve të edukimit" - u shpreh Ministria e Kulturës, Elva Margariti në ceremoninë e përvitshme të Varrit Monumental të Vendlindit Antik të Persqopit. Financuar nga Tourism Investment & Finance Fund, me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës ky monument është investimi më i ri në zonën e Tiranës sa i përket turizmit kulturor, duke zgjeruar

vizitueshmërinë në objektet e monumenteve të kulturës.

Projekti i miratuar në Këshillin Kombëtar të Restaurimit bëri të mundur kryerjen e ndërhyrjeve konservuese - restauruese, pastrimin e vegetacionit, ndërtimin e sistemit të drenazhit përreth varrit si dhe vendosjen e tabelave informuese. Varrri Monumental ndodhet në pjesën lindore të malit të



Vilës. Ai është pjesë e vendbanimit të njohur me emrin "Muret antike dhe varri i Persqopit", në malin e Petrelës. Varrri Monumental mendohet të lidhet me pjesën tjetër të vendbanimit të fortifikuar, që daton si i shekullit V-II p.e.s. Persqopi ishte një nga qytetet antike që nuk pati jetë të gjatë për shumë kohë. Mendohet se popullsia lëvizti dhe u vendos në Petrelë.

Opinion i Ditës

# Një fitore e vogël e "njerëzve të dhunshëm"

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... të gjitha, gjykatat, lutjet në polici, përgjërimit në bashki që të mos joshite me leje ndërtimi profile banditësh që duan të rrembejnë pronat e tjetër kujt, por më kot.

Në mbremje ktheheshin në shtëpitë e tyre, të mposhtur, të pashpresë, me dinjitet të nëpërkëmbur dhe pa mundur t'i shikojnë në sy fëmijët, të cilëve pas pak kohësh, nuk do ishin në gjendje t'i siguronin një strehë.

Kjo zgjati deri ditën që dy rrugaçë përbarimi shkuan t'i hidhnin në tokë me shkelma derën e godinës së tyre.

Aty ata zgjodhën të përdornin të vetmen armë që kishin. Të bllokoni rrugën kryesore. Të shtriheshin përmes saj me trupat e tyre. Të përlesheshin dhëmbë për dhëmbë me policinë. Të qenë të gatshëm për t'i vënë zjarrin të tërës.

Për çdo legjitimist që endet saloneve dhe ekraneve të Tiranës ata ishin thjeshtë ca vandalë, zaptues apo qoftë edhe huliganë.

Sepse një vendim gjykatë nuk duhet kundërshtuar, duke i bllokuar rrugën kalimtarëve të tjerë. Sepse policia që e ka për detyrë të zbatojë kërkesat e përbarimit, nuk duhet cenuar fizikisht. Sepse zjarr dhe flaka nuk janë mjete për zgjidhjen e problemeve. Sepse në këtë vend myslimanësh, na kanë mëkuar me një mendësi kristiane, që kur na godasin në njëerën faqe, duhet të jemi të gatshëm të kthejmë tjetrën.

Ata e injoruan këtë mësim. Të lënë në mëshirë të fatit ata u mbështetën tek arma e fundit që u kishin mbetur në dorë: Të ishin të dhunshëm.

Por për çudinë e shumëkujt, kjo



i nxori në dritë. Fillimisht, si pasojë e akteve dhe vetëmohimit të tyre, para shtëpisë që mbronin, u mblodhën të gjitha mediat. Pamjet rrëqethëse të grave me barë dhe fëmijëve që tërhiqeshin zvarrë nga policia pushtuan gjithë ekranet. Ato u bënë virale në rrjetet sociale, që vërshuan me një lumë akuzash ndaj këtij sistemi të padrejtë, ku gjykatat, përbaruesit, bashkia dhe policia renditen gjithmonë me të fortin dhe të pasurin. Ato po krijojnë një ortek kundër kësaj qeverisjeje që pretendon se është aleate me qytetarin.

Dhe në saj të dhunës (të tillë e

quajnë legjitimistët e Tiranës vullnetin për të mbrojtur me çdo mjet një të drejtë) ata fituan. Fituan, se me aktet e tyre tërhoqën vëmendjen ndaj një padrejtësie, fituan, se me gatishmërinë për vetësakrificim, bënë të mundur që publiku të njihje me persekutimin që po u bëhej, fituan, se duke qenë qenë të bindur se do të shkelnin edhe ligjin, po mbronin në fakt një kauzë legjitime.

Nëse do të ishin sjellë si qytetarë të urtë dhe korrektë, sot nuk do të kishin pasur fare shtëpi.

Policia nuk do të ishte tërhequr duke i hapur rrugë ultimatumit për shembjen e godinës.


Po të kishin heshtur, kryeministri i vendit nuk do të justifikohet publikisht duke thënë se qeveria nuk ka asnjë fuqi mbi vendimet e gjykatave. Po të ishin sjellë qetë kryebashkiaku nuk do të ofronte aty për aty banesa sociale, duke pohuar se nuk kishte dhënë leje ndërtimi. Po të kishin ndjekur "ligjin" dhe "rregullat" ministri i Brendshëm nuk do të kishte dënuar personalisht veprimet aspak dinjitoze të policisë.

Ky është mësimi, që ata 20 banorë i dhanë krejt shoqërisë.


Herë duke u barrikaduar në mënyrë qesharake pas portës së

tyre, ndërkohë që përballë kishin një lukuni me policë, herë duke lëshuar klithma epike, që më parë s'pati denjuar t'i dëgjonte askush, herë duke hedhur mizorisht në betejë edhe fëmijët dhe gratë shtatzënë, ata dëshmuar se pa dinjitetin për të reaguuar dhe pa zemërimin për t'u revoltuar, në sistemin që kemi ngritur, nuk zgjidh dot asgjë.

Ata zgjodhën rrugën e "dhunës" dhe i bënë mirë vetes së tyre. Por njëkohësisht na bënë mirë edhe ne, të gjithëve, që në vend të një kulle të re në Tiranë, fituam 20 qytetarë të denjë për këtë emër.



**BLUE  
TOOTH**



**te rejat  
nga jeta  
ipave**

çdo të shtunë falas me

**THASHETHEME  
MADE IN  
ALBANIA**


Opinioni *i* Ditës

# Të trembëdhjetët në bronz

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faja 1)

... së vet, duke qëndruar deputet, shqiptoi përpara pak kohësh një të vërtetë tejet të hidhur. Faktin që shumicën e tenderëve kryesorë publikë të vendit tonë në këta 8 vitet e fundit (rreth 4.2 miliardë euro) e kanë marrë vetëm 13 kompani më të mëdha tonat. Me pozita mbizotëruese në tregjet ku veprojnë (ndërtim, shitje me pakicë, etj.). Nuk ka asgjë të keqe që këto kompani të garojnë për parane e taksapaguesve të këtij vendi në kushte gare të barabartë. Me rregulla loje që nuk ndryshohen rrugës. Mirëpo problemi i madh i ekonomisë sonë publike qëndron se rregullat, ose janë ndryshuar në ankand e sipër, ose kanë ngelur fiktivë, kallpë, duke trukuar, shpërfytyruar garën. Dhe kanë humbur trefish qytetarët e këtij vendi nga mosrespektimi i këtyre rregullave. Së pari, kanë humbur, sepse ato objekte investimi publik (rrugë, ura, sheshe, etj.) apo shërbimesh (shëndetësore, doganore, etj.) kanë kushtuar shumë më tepër, në disa raste edhe me herë më shumë, se sa po të kishte patur garë të rregullt dhe të pastër. Së dyti, kanë humbur në mungesën e pranisë së firmave të huaja të njohura dhe me kapital nga jashtë Shqipërisë. Dhe dihet që në dhjetë vitet e fundit (2009-2018) kemi patur një mungesë ulëritëse pjesëmarrjeje në tenderët e shtetit tonë, edhe qindra milionë eurosh, nga ana e kompanive të huaja me emër në fushën e ndërtimit, shërbimit, etj., në rajon e më gjerë. Së treti, kanë humbur se paratë kryesore për të kryer veprat (akset rrugore, etj.) të tenderëve të fituara, këto 13 kompanitë tona do t'i marrin hua nga sistemi ynë bankar, pra nga të 14 bankat tregtare të vendit, duke ulur mundësitë që ne si qytetarë apo me mijëra sipërmarrjet e tjera private të marrin kredi. Ndërsa qytetarët kanë humbur trefish, pronarët e kompanive mbizotëruese vendase (ata që sot shumëkush me zell i quan apo "shan" oligarkë) janë ndërjerë më mirë. Madje, për ta rritja ekonomike ka qenë edhe 11 apo 12 për qind (si shtim i vëllimit të punëve apo fitimit), nga 4 për qind të mesatares së rritjes ekonomike të vendit. Kuptohet, me pëlqimin në heshtje ose veprimin aktiv të këtyre pronarëve, që ndryshuesit publikë të rregullave të lojës, drejtorët e drejtorive apo edhe ministrit kanë ditur si t'i miklojnë ose shpërblejnë. Ndërsa i huaji, kompania e huaj nuk arrin dot të bëjë muhabetin përpara ankandit, të tipit: "nëse komisioni i vlerësimit të ofertave më vlerëson mua të pari, 20 për qind të tenderit e ke ti dhe ministri yt". Jo. I huaji



thjesht depoziton letrat në rregull në ankand dhe pret të vlerësohet oferta e tij. Nuk merr guximin të sjellë në tender një kompani të shpikur nga përtej oqeanit, si kuturis një nga këta 13 mbizotëruesit vendas të tregut, të cilët qeveria jonë aq i ka vlerësuar dhe i vlerëson, sa të vjen të thuash i ka derdhur në bronz! Dhe opozita jonë sot ka marrë vrapin duke i sulmuar me emër e pa emër këta të trembëdhjetët në bronz. Duke i quajtur thjesht oligarkë dhe duke u premtuar njerëzve të revoltuar dhe të pakënaqur se, po të vijë ajo në pushtet, do t'ua heqë nga qafa dhe nga shala e tenderëve publikë. Kjo është të luftosh me mullinjë e erës, si Don Kishoti. Kur e di fare mirë se secili prej këtyre trembëdhjetë "oligarkëve" ka me-

satarisht të punësuar të paktën 1 mijë vetë. Se të gjithë së bashku i japin shtetit mbi 60 për qind të të ardhurave me taksat që paguajnë (për vete mbajnë, kuptohet shumë më tepër, shpesh edhe duke kryer rëndshëm shmangje tatimore-evazion fiskal, me aradhen e ekspertëve tatimorë të paguajnë). Dhe po të ishin vërtet të shqetësuar këta të trembëdhjetë të veshur në bronz nga qeveritë tona të djeshme e të sotme, janë në gjendje të mbledhin pesë herë më shumë njerëz përpara Kuvendit, se sa opozita. Për të protestuar, në mbrojtje të parasë që kanë vënë, nuk ka rëndësi se si. Por nuk janë të shqetësuar realisht. Pse e kuptojnë qartë që premtimet e opozitës sonë se do t'i nxjerrë nga loja e tenderëve sh-

tetërorë janë thjesht grepa për të kapur shpresën e humbur të njerëzve se ky vend mund të bëhet. Duke bërë gjoja luftë shtrigash ndaj oligarkëve, për të kanalizuar në dobi të saj zemërimin dhe zhgënjimin qytetar. Për ne qytetarët ka rëndësi të thuhet qartë që këta mbizotërues tregesh do të trajtohen si të barabartë në tenderët e ardhshëm. Ose, aty ku ka mundësi në tenderët që kanë nisur zbatimin, ose tek ata ku vetëm është nënshkruar kontrata, për të parët të rishikohen kushtet, për të dytët të kthehen mbrapsht. Këto gjëra reale duhet të na premtojnë opozita jonë, nëse e ka seriozisht të mos na bëjë budallenj dhe t'i shkojnë nga mbrapa, ose qeveria e sotme të veprojë sot, nëse dëshiron ta votojmë prapë nesër.

## HOROSKOPI

### DASHI

Të lindurit e kësaj shenje rekomandohet të ruajnë qetësinë kur kritikohen nga të tjerët. Kjo vlen mbi të gjitha për ata që kërkojnë t'u miratohet një projekt. Pasi të dëgjoni kritikën, përpuni të bëni më të mirën e mundshme për të rregulluar problemet.

### DEMI

Mund të përballemi me disa probleme në familje për shkak të veprimeve tuaja. Megjithatë, bëhet fjalë për mosmarrëveshje të vogla, të cilat do të kalojnë lehtësisht. Në aspektet e tjera të jetës do të keni fat.

### BINJAKET

Mund të ndiheni konfuz për shkak të disa eventeve gjatë ditës së sotme. Ka gjasa që rivali juaj prej shumë kohësh, t'ju kërkojë ndjesë dhe t'ju ftojë për darkë. Është koha e duhur për të investuar në një projekt afatgjatë.

### GAFORJA

Shumë Gafore do të jenë mjaft në humor. Shkëlqimi tek sytë tuaj do të vihet re nga të gjithë, veçanërisht nga seksi i kundërt. Është koha më e përshtatshme për ata që janë në kërkim të dashurisë. Sa i përket financave, do t'ju japin disa ide shumë të vlefshme.

### LUANI

Disa Luanë do të fokusohen tek korrigjimi i mangësisë. Ka gjasa që të tregoheni shumë të reptë në këtë drejtim, por bëni kujdes pasi kritikën e shumta ndaj vetes mund të ndikojë në sistemin nervor. Ndërkohë, parashikohet fat i mirë në marrëdhëniet personale.

### VIRGJERESHA

Duhet të gjeni një stil të ri jetese. Mos u frikësoni ndaj eksperimenteve. Do të ishte e udhës të mos ushtroni presion ndaj personave tuaj të afërt. Jepini të drejtën të kenë opinionin e tyre personal.

### PESHORJA

Mund të ndiheni të irrituar në marrëdhëniet tuaj romantike. Shkak i irritimit mund të jetë një trekëndësh dashurie ose indiferenca e shokut/shoqes suaj të ngushtë. Një situatë e tillë do të kalojë, pasi t'ju vizitojë një person, të cilit i besoni shumë.

### AKREPI

Disa Akrepi do të jenë në gjendje të kritikave për shkak të mospërmbyshjes së premtimeve. Do të ishte e udhës ta mbanit fjalën, në mënyrë që të mos cilësohen si gënjeshtar. Sa i përket marrëdhënies romantike, do të kaloni një ditë mjaft të këndshme.

### SHIGJETARI

Shigjetarët ka gjasa të sillen si kapriçozë. Mendoni rreth prioriteteve tuaja dhe përqendrohuni drejt suksesit. Mos mendoni se investimet në një projekt të paligjshëm mund t'ju sjellin rezultate pozitive. Mos u nxitoni para se të veproni.

### BRICJAPI

Gjatë ditës së sotme do të përqendrohni tek vetja juaj. Veproni me takt, pasi kjo do t'ju ndihmojë në çdo aspekt të jetës suaj. Mos u shprehni hapur me të gjithë personat që u rrethojnë. Tregohuni më të rezervuar dhe mos argumentoni me arrogancë gjatë debatoreve të caktuara.

### UJORI

Disa Ujorë janë të destinuar ta kalojnë ditën në kushte jo komode. Do të përballemi me negociata të vështira dhe ka gjasa të keni një mosmarrëveshje me një prej të afërmeve tuaj. Nuk është dita e duhur për të nisur zbatimin e një projekti të ri.

### PESHQIT

Gjatë kësaj dite Peshqit mund të risin potencialin krijues. Kjo është një mundësi unike për këdo që është i përfshirë në art. Sa i përket financave duhet të tregoheni të kujdesshëm, pasi lëvizjet e gabuara mund t'ju vënë në pozicion të vështirë.

TRONDITET BOTA E FUTBOLLIT

Prokuroria e Firences ka mbyllur hetimet për vdekjen e kapitenit të Fiorentinës, Davide Astori, të ndodhur më 4 mars 2018, para ndeshjes me Udinezen. Dy mjekët janë vënë nën akuzë për vrasje të qëllimshme. Bëhet fjalë për mjekun Francesco Stanjo, drejtor i Institutit të Mjekësisë të Sportit të Kajliarit dhe mjekun Xhorxho Galanti, drejtor



mjekësor i Qendrës Referuese për Mjekësinë Sportive në Firence. Sipas hetimeve, dy mjekët janë përgjegjës sepse për shkak të një kombinimi të shkaqeve mes tyre të pavarura, ata kanë provokuar vdekjen e Astorit duke shkelur "protokollet kardiologjike për gjykimin e përshtatshmërisë për sport konkurrues". Konkretisht, Stanjo akuzohet se i kishte lëshuar Astorit në korrik 2014 një certifikatë të përshtatshmërisë për sportet konkurruese, në të cilat u

Vdekja e Astorit, mjekët nën akuzë për vrasje të qëllimshme

vërtetua mungesa e kundërindikacioneve përkundër faktit që hetimet treguan se në provat e sforcos ishin verifikuar dy ekstrasistola ventricolare të izoluar që nuk ishin përmendur në raport. Ndërkohë ndaj Galantit, prokuroria kundërshton lëshimin për Astorin e dy certifikatave të ndryshme të përshtatshmërisë për praktikën e futbollit konkurrues në korrik 2016 dhe në korrik 2017, pavarësisht se sipas hetuesve ishin shfaqur aritmi kardiake në provat fizike. Stanjo dhe Galanti gjithashtu akuzohen se kanë dëshnuar për t'i bërë ish-kapitenit të Fiorentinës teste të tjera diagnostikuese më të thella mbi origjinën

dhe shkaqet e ekstrasistolave, në mënyrë që të përjashtonin "Cardiopatía organike" apo "Sindromin aritmogjen". Për prokurorinë, nëse patologjia ishte diagnostikuar ndërsa ishte në një fazë fillestare, do të kishte mundësuar ndërprerjen e aktivitetit konkurrues të Astorit dhe përmes trajtimeve me ilaçe sëmundja do të ishte ngadalësuar dhe kështu të parandalonte fillimin e "aritmitive ventrikulare malinje".

Kukësi do të kryesojë 2-0 në "Niko Dovana", por në pesë minutat e fundit, Teuta do të barazojë



Jeton Selimi

Luftëtari trondit Partizanin, barazim spektakolar në Durrës

Gjirokastritët përmbysin kryesuesit e kampionatit

Kanë nisur me surprizë çerekfinalin e Kupës së Shqipërisë. Partizani dështon në sfidën e vajtjes, duke u dorëzuar përballë Luftëtarit me rezultatin 2-1. Në sfidën pa tifozë të luajtur në "Elbasan Arena", kryesuesit e Superligës mbyllën pjesën e parë në epërsi, por u lejuan rivalëve të përmbysin gjithçka pas pushimit me një gol në limitet e kohës së rregullt. Ky fund nuk mund të imagjinohej në minutat e para. Të kuqtë e drejtuar nga Skënder Gega e nisën ndeshjen me një marsh më shumë, ndërsa në disa raste tu afruan golit të epërsisë. Asani, Trashë dhe Heba vendosën në vështirësi mbrojtjen gjirokastrite, por gjithsesi nuk arritën të ndalnin topin në rrjetë. Pas shumë përpjekjesh, rezultati do ndryshonte në minutën e 42-të. Telushi la pa shanse portierin kundërshtar me një goditje të fortë nga distanca, ndërsa goli i mesfushorit vlonjat vendosi fatin e pjesës së



parë. Pushimi në dhomat e zhyshjes duket se nuk i bëri mirë Partizanit. Me rikthimin në fushë, Luftë-

tari barazoi shpejt shifrat. Fili në minutën e 54-rt ndëshkoi ish-skuadrën e tij për të vendosur ekuilibrat

në rezultat. Në të 57'-ën, Heba ka rastin më të mirë për të kthyer sërish Partizanin në epërsi, por gaboi në rastin më flagrant të sfidës. Ofensiva e të kuqve vijoi gjatë, por finalizimi la për të dëshiruar. Në minutat e fundit u zgjua sërish Luftëtari, që pasi rrezikoi përmbysjen, e gjeti atë në limitet e kohës së rregullt, kur Rustem Hoxha ndali topin në rrjetë. Nuk sollën asgjë katër minutat shtesë, ndërsa në fund Partizani duhet të pranohet humbjen, që ndërlikon ndjeshëm misionin për t'u kualifikuar në gjysmëfinalin e Kupës. Ndeshja e kthimit do të luhet në Gjirokastrë dhe pas kësaj fitoreje, skuadra e Julian Ahmetaj është duk-

shëm e favorizuar. Ka përfunduar në një barazim spektakolar sfida e luajtur në "Niko Dovana" në kuadër të çerekfinaleve të Kupës së Shqipërisë mes Tetës dhe Kukësit, një sfidë që u shënuar nga gola të shkëlqyer dhe nga situata rokambolike. Verilindorët e drejtuar nga Armando Cungu kanë zhvilluar një sfidë shumë të mirë, por në fund janë dorëzuar nga një shpërthim i "Djemve të detit" që kanë rikuperuar dy gola në frymën e fundit. Pjesa e parë do të mbyllet me epërsinë e miqve, që shënojnë në limitet e saj me atë të Rexhinaldos, që në të 45'-ën realizon pas një aksioni shumë të bukur të Kukësit. Me fillimin e

pjesës së dytë Kukësi gjen golin tjetër me anë të Vasil Shkurtajit (54), gol që duket se shënon dhe fatet e dy skuadrave me djemtë e Cungut, të cilët janë një frymë pranë çerekfinaleve. Kukësi do t'i afrohet golit të tretë me anë të Rocës, por siluri i tij në të 67'-ën do të ndalet nga shtylla e Hidit. Teuta nis të shohë më shumë nga porta e Frashërit dhe pas traversës së Kallakut në të 77'-ën, do të vijjnë dhe golat. Fillimisht do të shkurtojë Bushiç në të 85'-ën, ndërsa në të 90'-ën bregdetarët do të barazojnë pas një këmbënguljeje të gjatë në zonë me anë të Hakajt. Një 2-2, që ë lë të hapur kualifikimin për në ndeshjen e dytë.

CHAMPIONS LEAGUE

Kristiano Ronaldo një "përbindësh", 3 gola për të kaluar Atletiko Madridin

Një përmbysje monum mentale, një përmbysje e kërkuar dhe e arritur. Një klimë e jashtëzakonshme në "Allianz Stadium", një klimë e përgatitur nga klubi torinez ditë më parë, duke karikuar ambientin me moton "get ready to comeback", çka u realizua falë një Kristiano Ronaldo të përbindshëm. Është pikërisht portugezi ai që çel rezultatin në pjesën e parë, kur me kokë mposht Oblak në shtyllën e dytë pas harkimit të topit nga Bernardeski. Por CR7 nuk do të ndalet me kaq, pasi do të vrapojë si i



çmendur gjatë gjithë takimit, ndërsa me fillimin e pjesës së dytë, sërish me kokë, sërish në shtyllën e dytë, mposht Oblak, që arrin te

topi, por pasi sfera kishte kaluar vijën. 2-0, çdo gjë është e barbartë. Spinacola asfaltton krahun e majtë, Emre çan vë rregull në mesfushë ndërsa Bernardeski është i papërbajtshëm. Sikundër në minutën e 83-të, kur me një sprint të fuqishëm futet në zonë dhe detyron mbrojtësin t'i shkaktojë faull. Nga pika e bardhë sërish CR7, është mbrëmja e tij, nuk mund të gabojë. Oblak nga e majta e topi në të djathtë të portierit, 3-0, përmbysja është servitur në një pjatë të argjendtë, Juventus kalon në çerekfinale, Atletiko është jashtë!

Projekti i ri mund të nisë

Zbulohen 6 kërkesat e Zidan ndaj Perezit




ndërmjet Navas dhe Kurtua. 3-Marselo dhe Izko. Të dy u lanë në stol nga Solari, ish-in shumë pranë largimit, por

si braziliani ashtu edhe spanjollit janë në qendër të projektit të Zidan. 4-Nejmar? Jo, faleminderit! Prej kohësh është folur për një kalim të brazilianit në Madrid, Zidane është kundër këtij transferimi. 5-Hames Rodrigues? Rikthimi i tij në Madrid tashmë është i pamundur ishte pikërisht Zidan, ai që e largoi. 6-Goditje të mëdha. Endrra e Zidan është Kilian Mbape. Nuk do të jetë aspak e lehtë, por ai do ta provojë. Emri i dytë është ai i përherëshmi, Eden Hazard.

Zinedin Zidan rikthehet te Real Madrid pas 9 muajsh, 8 ditësh dhe 2 shkarkimesh (Lopetegui dhe Solari) por për të bindur francezin nuk ishte aspak e lehtë, sipas mediave spanjolle kanë qenë jo pak, por 6 kushte që presidenti Perez është i gatshëm t'ia plotësojë:

- 1-Zidan ka kërkuar të jetë ai menaxheri i merkatos dhe të ketë autonomi totale mbi ekipin, pa pasur asnjë ndërhyrje nga drejtuesit e klubit.
- 2-Kush duhet të largohet? Gareth Bejl i pari, të njëjtin fat pritet të ketë edhe Karim Benzema dhe pse pak kohë më parë Perez u shpreh si Benzema është sulmuesi më i mirë në botë. Zidan dëshiron vetëm një portier titullar, i duhet të zgjedh një

**Fjalëkryqi (1)**



- 38. Fillojnë vonë.
- 39. Krijoi James Bond.
- 40. Ishulli i Odiseut.
- 42. Van der portier.
- 43. Një karamete aromatike.
- 44. Mund të shkojnë... nga frika.

**VERTIKAL**

- 1. Bëhet duke vënë në lojë.
- 2. Pak origjinale.
- 3. Thahet me bonifikim
- 4. Në fund djathtas.
- 5. Ishte Gjermania e Honecker-it.
- 7. Hidhet një për shesh.
- 9. Kokëkuaja në pit stop.
- 10. I famshëm ai i Stizfit.
- 12. Eshhtë në pikën më veriore e Shqipërisë.
- 13. Një diktator shtypës

**VERTIKAL**

- 1. Të para ato të Shollohov.
- 5. Fillojë luftën.
- 6. Liszt kompozitor.
- 8. Marsi në Areopag.
- 9. Kështu fillon filmi.
- 11. Gjysmë linear.
- 12. Një freskues në tavan.
- 18. Eshhtë gazeta Panorama.
- 20. Mund të jenë kamikaze.
- 21. Masat pa kufij
- 23. Venier e spektaklit italian.
- 25. Sophia e kinemasë.
- 26. Safin tenist.
- 29. Eshhtë makut, i pangopur.
- 31. Eshhtë faqe ene.
- 32. Një kafshë që hap... galeri.
- 33. Një ftyrë e keqe.
- 35. Preken nga sindroma Basedow.
- 37. Italia në Internet.

- 14. Lëvizja Socialiste Spanjole.
- 15. I kanë çift radhët.
- 16. Janë llahtarë.
- 17. Poeti kur nuk pi.
- 19. Fillojnë periudhën.
- 22. Omar që qe aktor.
- 24. Si sezonale.
- 25. Janë banorët në Riga.
- 26. Carey këngëtare.
- 27. Nuk i tregohen babait.
- 28. Bëjnë arte me re.
- 29. Kush ka... e ka humber toruan.
- 30. Një stacion orbital.
- 31. Fillojnë profesionin.
- 33. Gibernau i MotoGp.
- 34. I kanë të ndryshme tutat
- 36. Gjysmë ditari.
- 38. Varet me re.
- 41. Kufijtë e kuqtesës.
- 42. Sapo fillonjë.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**

- 1. Gustav kompozitor.
- 6. Në krye të kryesisë.
- 7. Lexohet në pentagram.
- 11. Sastre aktore.
- 12. Gjysmë akordi.
- 15. Dhjetë angleze.
- 16. Satira për zë.
- 18. Eshhtë situata e tensionuar.
- 21. Pak teatrale.
- 22. Bëhet me mea culpa.
- 24. Fundi i një samurai.
- 25. Mbeten në fund.
- 26. Lind në kokë.
- 28. Në radhë të parë.
- 29. Inicialet e Camus.
- 30. Një verë në Paris.
- 31. Partizani i vogël... në një film tonin.
- 33. Litra pa kufij.
- 35. Eshhtë fatë.

**VERTIKAL**


- 36. Një pjesë e kinematografisë.
- 37. Një pjesë e akademisë.
- 39. Kufijtë e tretjes.
- 40. Mbyll të çarën.
- 41. Erik çiklist.
- 43. Një pjesë e medaljes.
- 44. Njësi matëse e shpërthimit atomik.
- 46. Pak torturuese.
- 48. Ka privilegjin e jetës
- 51. Mbyllin një spital.
- 52. Mbylltet me dorezë.
- 53. Ishin kalorësit si Rolandi
- 54. Ndal në... kryqëzim.




**VERTIKAL**

- 1. Janë enigmatikë.
- 2. Mund të jenë parabolike.
- 3. Ishte xhelozia e Olimpik.
- 4. Kufijtë e lëvizjes.
- 5. Fillojnë radhitjen.
- 6. Janë kushte.
- 8. Totem pa ekstreme.
- 9. Mbyllin kanate.
- 10. Shoqëronte Edipin e verbër.
- 13. Eshhtë gjeli.
- 14. Moore aktore.
- 17. Janë forcat e Reneas.
- 19. Janë përmasa.
- 20. Fund dhjetori.
- 23. Mbyllin dritaren.
- 26. Fillojnë matjet.
- 27. Duhet ruajtur.
- 32. I bën një serenatë Rosina-s.
- 34. Gjysmë rabini
- 38. Mustafa.. Atatürk.
- 40. Të parat në Amsterdam.
- 42. Ai i muzave është Helikona.
- 45. Një pjesë e gadishullit
- 47. Muzika e Eminem.
- 49. Fillojnë operacionin.
- 50. Kapen të parat.
- 52. Kufijtë e drejtëzës.

**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

			6						
							5		1
3	6	9		8			4		
					6	8			
			1	3					9
4		5			9				
							3		
		6			7				
1			3	4					

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

1	3	7	2	8	5	9	4	6
4	2	8	9	6	7	5	1	3
9	5	6	1	3	4	7	2	8
7	6	5	3	9	1	4	8	2
2	8	9	4	5	6	1	3	7
3	1	4	7	2	8	6	5	9
5	7	3	8	1	9	2	6	4
8	4	1	6	7	2	3	9	5
6	9	2	5	4	3	8	7	1

*Argëtim filozofik*

- Jeta është një teatër ose më mirë një dramë, ku rolet i luajnë puthjet, të qeshurat dhe të qarat.
- Rruga drejt lumturisë nuk është e drejtë... Ka shumë kthesa të quajtura "gabime".
- Dhimbja më e madhe kur duam dikë, është paaftësia jonë për ta parandaluar atë që të vuajë nga vetmia e tij.
- Burgu më i madh në të cilin njerëzit jetojnë është frika se çfarë mendojnë të tjerët!!!
- I lumtur është ai njeri që di se çfarë të mbajë mend nga e kaluara, çfarë të shijojë në të tashmen, dhe çfarë të planifikojë për të ardhmen.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

12	6	10	2		15	10		15	1	11
1	9	3	7		8		2	7	16	11
4	1	10		5	3	9	3	8	2	12
2	9		16	6	4	2	8	6	9	2
18		12	1	15	2	8	1	11	2	7
6		11	1	15	9	1	8		1	1
4	3	1		3	8		11	16	8	2
2		7		9	3	2	4	3	8	2
	15	2	7		7	S	O	10	D	A
7	3	12	9	3	8		11		17	6
1	11	3		11	6	4	10	9	1	9
8	3	5		1	18	10	3	9	1	3

D	R	I	T	A	R	E	T	B	O	T	E
O	R	A	P	F	B	E	L	A	T		
B	I	K	O	L	O	N	E	L	B	I	
I	F	I	T	O	R	E	T	T	E	K	
H	K	O	M	E	N	T	E	T	E	L	E
T	A	M	T	A	M	A	S	R	A		
D	T	E	K	S	T	M	I	T	E	T	
E	H	R	R	I	K	I	L	O	N	I	
M	I	R	I	A	M	K	R	E	R	E	T
I	T	A	P	I	N	A	T	I	O		

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

P	E	T	E	R		P	A	M	O	R	E		
A	M	E	N		K	B	A	N	O	R	E	T	
P	R	I	E	A	M	I	F	A	E	D	E	M	A
P	I	E	A	N	A	T	E	M	A	T			
R	T	E	L	E	P	A	T	I					
E	K	O	N	O	M	I	K	E		R	E	S	
K	E	N	E	T	A	T	R	O	B	E	R	T	
E	M	R			E	H	R	O	M	B	I		
S	I	N	G	E	R	I	N	A	T				
N	A	J	D	I	T	E	R	T					
S	H	I	N	E	N	E	M	T					
D	A	M	A	R	T		A	K	T	E			
S	P	O	T		P	B	A		A	L	E	F	A
A	S	O	P	E	R	E	T	A	T	A	S		
U	O	P	E	R	A	T		D	O	R	A		
L	I	P	E	T	P	O	T		T	M	I	A	
L	I	Z		T	O	R		T	L	E	O	N	
A	T	I		A	N	T	E	U		E	N	I	
D	I	T	A		I	L	L		L		M	I	S
A	M	A	N	E	T		A	L	G	A	T		
E	I	R	I	S		A	R	E	N	E			
S	T	O	L	I		K	U	R	A	T	A	R	
P	M	A	K	E	T		E	L	E	H	T	E	



*Thënie të mënçura*

- Pengesa më e madhe është frika... ndjenja më e keqe është zemërimi... dhe gabimi më i madh është braktisja!!!
- Tendenca për të shmangur përbaljen me problemet tona dhe barrën emocionale të dhimbjes, është baza primare për të gjitha sëmundjet mendore.
- Nëse heshtja i përshpërfaqton të mençurit, sa herë më shumë i përshpërfaqton budallat?
- Gjithkush dëshiron të shkojë në parajsë, por askush nuk dëshiron të vdesë.
- Pak i shohin gjërat ashtu siç janë. Disa perceptojnë vetëm atë që duan të shohin; dhe disa të tjerë atë që i bëjnë të tjerët të shohin.

